

1. HISTORIK I SHKURTER I SISTEMIT ARESIMOR NE SHQIPERI (PARA VITEVE '90 DHE PAS VITEVE '90)	2
1.1 Sistemi aktual aresimor.....	4
2. TE DHENA TE TREGUT	5
2.1 Historiku I shkollave jo-publike ne Shqiperi.	5
2.2 Analiza e sektorit.	8
2.3 Forcat e tregut te sektorit te aresimit.....	13
2.3.1 Shkollat jo-publike- fuqia e tyre	13
2.3.2 Zevendesuesit -Shkollat publike	14
2.3.3 Hyresit e rinj.	14
2.3.4 Klientet –fuqia e tyre.	15
3.TREGU AKTUAL I SHKOLLAVE JO-PUBLIKE.....	16
3.1 Numri i shkollave jo-publike.	16
3.2 Struktura organizative e shkollave jo-publike	19
3.3 Personeli aresimor.....	19
3.4 Raporti student / mesues	20
3.5 Burimet e financimit te shkollave	22
3.6 Infrastruktura e shkollave jo-publike.	22
3.7 Shperndarja gjeografike	23
3.8 Sherbimet shtese qe ofrojne shkollat jo-publike ne krahasim me ato publike.....	28
3.9 Analiza e pikave te forta e te dobeta (Analiza SWOT)	29
3.9.1 Fuqite	29
3.9.2 Dobesite	30
3.9.3 Kercenimet	31
3.9.4 Shanset	31
3.10 Tendenca e tregut.....	31
4 KONKURRENCA E TREGUT.....	34
4.1 Aktoret kryesore ne tregun e aresimit (publik dhe jo-publik).....	34
4.2 Shkollat e huaja prezente ne Shqiperi.	35
4.3 Rrjetet e shkollave.....	36
4.4 Targetimi i studenteve nga dhe te ardhurat e familjeve frekuentuse.	36
5 TARIFAT E PAGESES KUSHTET E TYRE.....	37
6 PARAMETRAT DHE STANDARTET	39
6.1 Legjislacioni perkates	39
6.2 Lejet dhe rregulloret.....	40
6.2.1 Leja për funksionimin e institucioneve arsimore jopublike (IAJP) dhe institucioneve arsimore plotësuese jopublike (IAPJP), laike dhe në gjuhën shqipe.....	40
6.2.2 Kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për dhënien e kësaj lejeje.....	40
6.2.3 Proçedurat e miratimit të lejes	41
6.2.4 Afati kohor	42
6.2.5 Kostoja për dhënien e liçensës	42
6.2.6 Leje për funksionimin e IAJP dhe IAPJP, fetare ose me mësim në gjuhë të huaj	42
6.2.7 Dokumentat që duhen për dhënien e lejes	42
6.2.8 Afati kohor për dhënien e lejes	44
6.2.9 Leje për funksionimin e shkollave të larta jopublike.....	44
6.2.10 Kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për marrjen e kësaj lejeje	44
6.2.11 Afati kohor	45
7 KONKLUSIONE.....	46

STUDIMI I TREGUT TE SHKOLLAVE JO-PUBLIKE NE SHQIPERI

1. HISTORIK I SHKURTER I SISTEMIT ARESIMOR NE SHQIPERI (PARA VITEVE `90 DHE PAS VITEVE `90)

Aresimi ne Shqiperi ka qene dhe vazhdon te jete nje nga vlerat themelore te shoqerise dhe nje nga celesat e te ardhmes se saj. Aresimi shqiptar fillesat e veta l ka qe ne shekullin XVII, por dokumentat e para te shqipes se shkruar l perkasin shekullit te 15-te . “Meshari” l Gjon Buzukut , botuar ne 1555, eshte libri me l vjeter ne gjuhen e sotme shqipe, megjithese mendohet qe ai mund te jete mbeshtetur ne nje tradite edhe me te hereshme te shkrimit te shqipes.

Pushtimi otoman l solli vendit nje prapambetje te pergjitheshme, ekonomike, kulturore dhe aresimore, megjithate ne shekujt e 17-18-te mori hov ndertimi l medreseve dhe shkollave islamike, ku pervec mesimit te fese islame, jepeshin edhe disa njohuri shkencore. Ne vitin 1750 u krijua Akademia e Voskopojes, e cila u shnderrua ne nje qender te rendesishme per zhvillimin e kultures dhe te mendimit didaktik.

Perpjekjet per zhvillimin e aresimit moren hov gjate epokes se Rilindjes Kombetare. Lidhja Shqiptare e prizrenit (1878-1881) hartoi programin per njohjen zyrtare te gjuhes dhe shkolles Shqipe. U caktua nje alfabet i perbashket dhe u botua libri “Alfabetarja e gjuhes Shqipe”

Me 7 Mars 1887 u hap mesonjetorja e pare shqipe e Korces, qe konsiderohet edhe e para shkolle fillore shqipe me fizionomi te plote kombetare, laike dhe demokratike. Mesonjetorja Shqipe ne Kosove u hap ne Prizren ne 1889.

Shkolla e pare ku pergatiteshin mesues (shkolle e mesme pedagogjike), u cel ne Bukuresht te Rumanise ne vitin 1892, ndersa ne Shqiperi nje shkolle e tille, Normalja, u hap ne qytetin e Elbasanit ne dhjetor te vitit 1909, sipas vendimit te Kongresit Kombetar te Aresimit, mbajtur me 02.09.1909.

Me shpalljen e pavaresise me 1912, per here te pare ne historine e Shqiperise aresimi dhe shkolla shqiptare u organizuan dhe u drejtuan nga Qeveria Kombetare , duke hedhur ne kete menyre bazat e legjislacionit aresimor shqiptar. Ne vitet qe vazhduan u bene perpjekje per organizimin e shtetit ligjor, stabilizimin e aresimit, konsolidimin e shkolles fillore te detyruar(5 vjet ne qytet, 6 vjet ne fshat) dhe krijimin e sistemit te plote te aresimit te mesem. Me 1933 u be shtetezimi l shkollave dhe deri ne 1939 ne te gjithë vendin numeroheshin 643 shkolla fillore, te cilat frekuentoheshin vetem nga ¼ e femijeve te kesaj moshe.

Pas Luftes se Dyte Boterore Shqiperia u shpall Republike Popullore dhe me 1946 miratoi reformen e pare aresimore. Reforma konsistonte ne krijimin e nje sistemi te ri aresimor te ndertuar mbi parime socialiste dhe ne shnderrimin rrenjesor te kritereve ideologjike, shkencore e pedagogjike te procesit mesimor edukativ, mbi bazen e

parimeve te ideologjise marksiste-leniniste. U percaktua struktura e aresimit te pergjithshem, kohezgjatja e te cilit u shkrutua nga 13 vjet ne 11 vjet; aresimi fillor 4 vjet, aresim unik 3 vjet dhe ai i mesem 4 vjet. Aresimi fillor dhe me vone ai 7-vjecar u shpall i detyrueshem. Shkolla u konsiderua e barabarte per te gjithë , si per djemte dhe vajzat e qytetit ashtu edhe per djemte dhe vajzat e fshatit. Vijoi me tej lufta kunder analfabetizmit. Shkolla ne pare e Larte ne Shqiperi, Instituti i Lrte pedagogjik, u hap ne Tirane ne vitin 1946. Me 1951 u hapen institute te tjera te larta dhe me 1957 u cel Universiteti Shteteror i Tiranës. Nje ndihmese te rendesishmene ate kohe ka dhene shume edhe shkolla e vndeve te lindjes dhe ajo ruse ne vecanti. Keto universitete me eksperience, neperjet studenteve tane atje si dhe literatures qe dergonin ne forme granti ndikuan shume edhe ne strukturen e didaktiken e shkollave te larta ne shqiperi.

Ne 1965, aresimi i detyruar kaloi nga 7 ne 8 vjet dhe aresimi i mesem i pergjithshem u shtri ne 12 vjet. Planet dhe programet mesimore u permiresuan, duke bere ndryshime te ndjeshme ne forcimin e brendise ideologjike. Ne vitet `80 u bene perpjekje per modernizimin e planeve dhe programeve mesimore te hallkes parauniversitare te sistemit, nen frymen e ndryshimeve ne nivel kombetar. Puna u perqendrua kryesisht ne lendet e shkencave natyrore, permbytja dhe metodat e mesimdhenies se te cilave u permiresuan shume. Gjithashtu edhe ne shkollat e larta u fut nje fryme e re per futjen me intensitet te literatures perendimore qe deri ne ate kohe ishte teper e limituar kjo per shkencat natyrore se per shkencat filizofike e ideologjike ishte kategorikisht e ndaluar.

Pas vitit 1990 nis etapa e shnderrimeve te thella shoqerore. Shqiperia kaloi nga nje sistem socialist me ekonomi te centralizuar ne nje sistem te ri ate kapitalist me baze ekonomine e tregut ne nje sitem demokratik. Keto ndryshime patjeter qe gradualisht u reflektuan edhe ne aresim duke sjelle me vete disa fenomene qe ne periudhen e pare te viteve nentedhjet e demtuan shkollen shume por qe me tej i krijuan asaj disa perparesi.

Keshtu ne periudhen e pare u vu re fenomeni i braktisjes se shkolles si dhe ulja e regjistrimeve ne arsimin e detyruar. Edhe ne shkollate e larta u vu re fenomeni uljes se regjistrimeve. Faktoret qe ndikuan dhe sollen keto dy fenomene shume negative ishin me baze kryesisht ekonomike dhe kryesisht per arsimin e detyruar. Keshtu emigrimi i shqiptareve reth gjysem milione njerez ne vitet e pare te viteve 90 beri qe nje pjese e mire e nxenesve te braktisnin shkollen, nje kontigjent i mire i nxenesve ne zonat rurale duke qene se familjet e tyre u perballen me kushte te veshtira ekonomike i detyruan femijet te mos shkonin ne shkolle por te punonin per te rritur disa te ardhurat e familjes. Disa familje duke pare qe te ardhurat ishin nje faktor i rendesishem ne egzistencen e familjes dhe te jetes se cdo individi e nenvleftesuan faktin e edukimit te femijeve dhe me indiferencen e tyre u bene mbeshtetes te braktisjejs se shkolles nga ana e femijeve te tyre. Ne shkollate e larta fakultetet te tilla si ai i minierave metalurgjise, tekstilit, filozofise, deri diku inxhinjerite mekanike e lektrike, agrobujqesia etj duke pare qe nevoja per kuadro ne ekonomine e re ne keto dege sa vinte e zvogelohej, pe arsye te falimentimit te degeve prodhuese ne vend te ketyre industrive, e reduktuan shume numrin e regjistrimeve te reja. Gje e cila u kompensua ne nje faze te dyte me ndergjegjesimin e studenteve per keto nevoja dhe me hapjen e fakultetevev te reja. Tendencia e te shkolluarit ne universitete te huajaj e

kryesisht perendimore pati gjithashtu ndikimn e saj ne uljen e studenteve ne fakultetet tona.

Nje fenomen qe demtoi shkollen ishte dhe reduktimi i buxhetit dhe mos mbeshtetja sa duhet e shkollave ne zonat rurale. Shume mesues te ketyre zonave u detyruan, ne baze edhe te levizjeve demografike qe pesoi vendi, te spostohen kryesisht ne zonat urbane duke ndryshuar edhe profesionin e tyre per te siguruar te ardhurat per familjet.

Futja e literatures se re dhe kurikulave te reja filloi duke u realizuar ne menyre spontane nga mesues te pasionuar dhe kurojor por kjo JO e bazuar ne nje reforme te caktuar apo strategji te krijuar nga Ministria e Arsimit apo qeveria.

Keto fenomene dhe shnderrime shtruan para sistemit aresimor nevojën per ndryshime te shpejta, te thella dhe konceptuale si:

- Heqjen e permases politike dhe ideologjike te sistemit monist nga kurrikulat e te gjitha niveleve te aresimit parauniversitar.
- Perfshirjen ne kurrikulin e aresimit parauniversitar te lendeve te reja, disa prej te cilave sollen dhe kuptime te reja te kurrikulit te integruar, extra –kurrikulit dhe kros-kurrikulit:
- Perfshirjen e komponenteve te rinj ne strukturen e kurrikulit te aresimit parauniversitar:
- Modernizimin e metodologjive te mesimdhenies edhe nepermjet projekteve ne baze rajoni dhe shkolle, duke patur ne qender nxenesin dhe zhvillimin e mendimit te pavarur e krijues te tij:
- Zhvillimin profesional te mesuesve e te drejtuesve te aresimit nepermjet trajnimeve per te percjelle konceptet bashkekohore dhe per te menaxhuar situatat e krijuara nga tranzicioni:
- Zvogelimin e javes mesimore ne aresimin parauniversitar, ne perputhje me kushtet socio-ekonomike te krijuara rishtas
- Krijimin e nje reforme kombetare per arsimin
- Krijimin e degeve te reja arsimore ne universitete
- Dhe nga me te rendesishmet lindjen e institucioneve arsimore jo-publike.

Keto ndryshime kane qene dhe vazhdojne te jene elemente te rendesishem te reformes se sistemit aresimor ne Shqiperi.

1.1 Sistemi aktual aresimor

Aresimi ne te gjithë komponentet e tij, eshte financuar dhe vazhdon te financohet nga buxheti i shtetit me fonde te caktuara per cdo vit, si dhe nga organizma nderkombetare ne forme grantesh per projekte te rendesishme qe monitorohen prej tyre. Buxhetet e akorduara nga Qeveria per aresimin kane ardhur duke u rritur nga viti ne vit. Vlen te theksohet se financimi per arsimin eshte zeri me vleren me te madhe ne buxhetin e shtetit. Megjithetë perseri shkolla jone le per te desheruar shume persa i perket kualifikimit masiv te studenteve te saj. Shume studente te mire

ikin prej saj vetem per te marre nje diplome te njohur nga ndonje universitet jashte shtetit.

Per kete arsye megjithë mbeshtetjen e madhe te buxhetit te shtetit si nje nevojë e pakontestueshme e kohës dhe e tregut rilindi sistemit aresimor jo-publik pra ai privat. Kjo nje histori e kthyer qe para viteve 1944.

2. TE DHENA TE TREGUT

2.1 Historiku I shkollave jo-publike ne Shqiperi.

Sektori I shkollave jo-publike ne vendin tone eshte nje sektor relativisht I ri , por qe po merr nje zhvillim te konsiderueshem, sidomos ne gjysmen e dyte te viteve netdhjete dhe ne vitet e para te mileniumit te ri.

Deri **ne vitet `90**, si edhe cdo gje tjeter ne vendin tone edhe sistemi aresimor ishte strukture krejtesisht e menaxhuar nga shteti. I gjithë sistemi ka qene I dominuar nga pershkrimi I nje fryme ideologjike partiake, e cila reflektohej dukshem edhe ne kurrikulat e nexenesve. Pas ndryshimeve te medha qe zune vend ne vitet `90 edhe sistemi aresimor u prek duke u sfiduar nga celja e shkollave jo-publike. Tendencë e pare ne kete drejtim u vu re ne hapjen e sistemeve parashkollore private, te cilat sfiduan sistemin e kopshtit shteteror, I cili gjate viteve ne fjale mund te thuhet se nuk po funksiononte. Godinat dhe ambjentet ishin tejet te amortizuara, klasat dhe ambjentete po mbipopulloheshin, cilesia e mesimdhenies po binte, migrimet e shumta te popullsise, sidomos per ne Tirane apo per ne qendrat e tjera te medha urbane, bene qe kerkesa per sistemin aresimor te vinte ne rritje. Nderkohe kerkesa e madhe qe lindi (si rezultat i levizjeve te medha demografike nga zonat rurale ne drejtim te atyre urbane) per sherbime ne kete sektor nga njera ane dhe kapacitete e reduktuara te planifikuara qe me pare bazuar ne nje levizje te kontrolluar te popullsie nga ana tjeter cuan ne krijimin e nje disbalance te madhe midis kerkese se madhe dhe ofertes se vogel ne treg. Ky fenomen u be shtyse per subjektete private qete investonjne dhe te ofrojne kete lloj sherbimi. Keto qene edhe disa nga aresyet kryesore qe cuan fillimisht ne celjen e kopshteve dhe me pas ne celjen e shkollave te para jopublike.

Fillimi i ketyre iniciativave u shfaq ne **vitet 1993-1994** reth dy vjet mbasi u krijua edhe nje shtrese e njerezve qe krijuan disa burime financiare qe mund te perballonin edhe nje pagese mbi shpenzimet tradicionale familjare per mbarevajtjejn dhe aresimin e femijeve te tyre ne nje menyre me komode e te regullt se sa tregu i institucioneve publike.

Nder institucionet e para jo-publik ishin fillimisht kopshtet ne tirane dhe disa institucione edukative me baze besimi si medrese, edukimi katolik etj. Nder shkollat e para jo-publike ne shqiperi e rikthyer ne pronesi te origjines eshte instituti aresimor Harry Fultz. Me vone u shfaqen shkollat me investitore te huaj si Turgut-Ozal, Mehmet-Akif, Don-Bosko, Galileo-Galilei etj. Shkolla e pare me pronesi te plote shqiptare jo-publike e licensuar daton **ne vitin 1998**, u quajt Liceu INKUS dhe u

mendua si nje shkolle e mesme me profil kryesor linguistiken por qe shume shpejt u kthye me program te pergjithshem.

Me pas reth **viteve 2000-2001** kjo iniciative u pasua edhe nga shume sipermarrje te tjera , norma e rritjes se te cilave ishte shume e larte ne raport me harkun e shkurter kohor. Sipermarrjet e para ne kete fushe linden ne Tirane, dhe menjehere kjo ide filloi te perhapej edhe ne rrethe te tjera te vendit, por qe ende edhe sot e kesaj dite nuk kane ritmet e rritjes si ne kryeqytet. Ky disporpocion ritmesh i referohet disa faktoreve si madhesia e tregut, mentaliteti, mundesite reale, investitoret e huaj, mundesite ekonomike, lidhjet e binjakezimet me shkollat e huaja, vleresimi dhe ndergjegjesimi i popullates, influencat mediatike etj.

Aktualisht ne vendin tone numerohen rreth 229 institucione jo-publike edukative me 25813 nxenes dhe te ndare ne kater kategori si me poshte:

- Arsimi parashkollor 85 ku futen kopshtet dhe kane reth 4151 femije me 223 edukatore me nje mesatare reth 1 edukator per 17-20 femije.
- Arsimi i detyrueshem tete vjecar 90 jane shkolla me 13553 nxenes dhe 1023 mesues.
- Arsimi i mesem 51 shkolla nga te cilet 8 profesionale. Me 7704 nxenes nga te cilet 2077 ne shkolla profesionale dhe me 722 mesues nga te cilet 174 per shkollat profesionale.
- Arsimi i larte ka vetem tre universitete aktualisht jane reth 405 studente dhe 54 pedagoge (keto shifra i perkasin vetem dy universiteteve mbasi i treti eshte hapoyr vetem tani dhe akoma nuk ka te dhena te sakta). Universitetet jane vetem ne Tirane.

Edhe kete vit shkollor 2004-2005 jane dhen disa leje nga Ministria e Arsimit dhe Shkences per disa institucione edukimi jo-publike ne nivele te ndryshme.

Institucionet jo-publike mund ti ndajme ne dy kategori te medha:

- Institucione jo-publike jo fitimprurese dhe si te tilla jane kryesisht ato te besimit fetar apo institucionet qe fiancohen nga komunitetet e bashkeatdhetareve ne vendet e zhvilluara ex-emigrante dhe nje i tille eshte edhe Instituti Hatrry-Fultz me dy njesite e tij shkolla e larte Harry Fults dhe Community College.
- Institucione jo-publike fitimprurese dhe si te tilla jane shkollat kopshtet dhe universitetet e ndryshme me aktivitete te tatueshme plotesisht nga ortganet tatimore.

Shkollat e para jo-publike u vu re shume shpejt qe ishin shume me efektive sesa ato publike.

- Ne radhe te para kushtet e brendeshme te mesimdhenies ishin tejet te mira, pasi sipermarresit e ketyre aktiviteteve private kishin arritur te siguronin ambjente te pershtateshme me qera si dhe te bejne investime te konsiderueshme ne brendesi dhe jashte tyre, duke i pershtatur ato ne ambjente shkolle. Godinat ku zhvillohej mesimi ishin komode dhe te pajisura me se miri me te gjitha mjetet dhe ambjentet e nevojeshme dhe me te domosdoshme per nje zhvillim normal mesimor.

- Se dyti ne keto shkolla te para, u be nje pune shume emire per seleksionimin e stafeve te pergatitura pedagogjike (kryesisht meues te ardhur nga shkollat publike, por qe kishin eksperienca shume te mira pune). Kjo ishte edhe nje lloj terheqjeje per prinderit e femijeve te regjistruar ne keto shkolla.
- Se treti shkollat e para jo-publike kishin nje numer shume te vogel nxenesish per klase gje qe ishte konkurruese ne raport me shkollat publike te cilat ishin te mbipopulluara tashme.
- Nje sherbim i mire dhe shume terheqes i shkollave jo-publike ishte edhe siguria e larte e nxenesve brenda ambjentit te shkolles si dhe levizja e tyre e siguruar nga shtepia ne shkolle dhe anasjelltas. Te qenurit i sigurte per femijen, qe eshte larg fenomeneve te keqija mbasi eshte ne nje shkolle me roje dhe obligimin per te qendruar brenda ambjenteve te shkolles ne menyre te detyrueshme gjate orarit te mesimit, e josh shume prindin. Shpesh gjate intervistave prinderit jane shprehur “Te pakten e kam te sigurte femijen” po keshtu edhe disa drejtues nder gjerat e vecanta e te rendesishme te shkolles kane shprehur “sigurine e larte per femijet”

Duke pare ecurine e mire te aktivitetit shkollave te para jo-publike dhe nivelin e kenaqesise se perfituar nga prinder te ndryshem qe po testonin keto forma aresimore per femijet e tyre, u vu re nje rritje e shpejte e kerkeses per kete lloj sherbimi te diferencuar. Nderkohe kjo kerkese ne rritje po krijonte mundesira shume te mira per hyres te rinj ne kete sektor si nga ana e klienteve ashtu edhe nga ana e operatoreve. Keshtu qe shkollat e para jo-publike shume shpejt u ndoqen nga celja e nje sere shkollash te tjera te cilat pervec te tjerash filluan te konkurrojneme njera tjetren ne shume drejtime si ne mesimdhenie, administrim , ambjente, cmime, stafe pedagogjike etj. Shkolla e pare jopublike ehste hapur ne Tirane, madje po ne Tirane regjistrohet edhe numri me i madh i shkollave ne rang vendi. Megjithate edhe ne rrethe ka sipermarrije te tilla, edhe pse jo ne numer dhe ne permasa sa ne Tirane.

Institucionet jo-publike kane natyra dhe profile te ndryshme. Shumica e tyre ofrojne vetem nje sistem ate 8-vjecar ose te aresimit te mesem. Nderkohe qe jo pak ofrojne dy apo edhe tre sisteme ate parashkollor, arsim tetevjecar dhe arsim te mesem. Ndersa disa shkolla jane te profilizuara per profesione te caktuara.

Vetem ne rrethin e Tiranës jane te licensuara 105 institucione jo-publike. Nga keto jane 35 per arsimin parashkollor, 47 per arsimin tetevjecar, 20 per arsimin e mesem 3 prej te cilave profesionale si dhe tre universitete.

Per sa i perket sistemit aresimor universitar dhe pasuniversitar kjo pjese e sektorit te aresimit jo-publik eshte ende pothuajse plotesisht e zbrazet, pasi deri me sot vazhdon te konkurroje forte sistemi aresimor shtetror me dhe pa shkeputje nga puna. Shkolle e pare universitare deri me sot eshte vetem NewYork University, i cili eshte licensuar dhe hapur ne vitin 2002 dhe ende prej tij nuk ka dale brezi i pare te te diplomuarve. Nderkohe qe po ky universitet ofron edhe studimet pasuniversitare te nivelit Master dhe Ph.D per studentet qe mbarojne studimet ne kete universitet.

Ne vitin 2004 u licensua edhe universiteti “Zoja e Keshillit te Mire “, i cili ende nuk eshte hapur dhe mendohet te filloje te funksionoj ne vitin ne vazhdim.

Sipas te dhenave per rajonin vendi yne renditet i fundit per numrin e te diplomuarve per 10 000 banore. Ndaj mund te thuhet se kjo pjese e sektorit te aresimit jo-publik eshte ende e pashfrytezuar.

2.2 Analiza e sektorit.

Sektori i shkollave jo-publike eshte nje sektor relativisht i ri dhe ne rritje e siper. Per nga vete natyra e tij, pra perfshin nje klientele te moshave te ndryshme, duke filluar qe nga parashkoloret e deri tek pasuniversitaret, ky sektor mund te thuhet se eshte shume i larmishem.

I gjithesektori eshte strukturuar sipas te njejtessinfrastrukture si aresimi publik. Ai perfshin ofrimin e aresimit parashkollor (kopshtet), aresimin 8-vjecar, ate te mesem, te larte dhe pasuniversitar.

Gjithashtu edhe kurrikulat kryesore qe trajtohen ne keto shkolla jane po ato te sistemit publik dhe te licensuara nga Ministria e Aresimit dhe Shkences. E vecante e ketyre shkollave eshte qe ata japin edhe gjera shtese ne procesin edukativ si dhe perdorin kurrikula te specializuara per profile te vecanta qe nuk jane ne institucionet publike.

Ne kushtet e nje zhvillimi kompleks dhe dinamik ne vendin tone edhe ky sektor po peson ndryshime te dukeshme. Natyra e ndryshimeve te sektorit eshte e gjere dhe ne po shprehim me poshte nje analize te ketyre ndryshimeve ne keto shkolla:

- **INSTITUCIONI**

Fillimisht mjediset e institucioneve te para jopublike si kopshte shkolla tetvjecare, te mesme e profesionale ishin kryesisht te marra me qera, madje



***Pamje nga jashte e shkollave
jo-publike***

Tiranes duke permbushur ne kete menyre nje nga kushtet kryesore te mesimdhenies qetesine ne te cilen duhet te zhvillohet mesimi.

nje pjese e mire e tyre ende vazhdojne te operojne ne kete menyre. Mirepo nje pjese e konsiderueshme e tyre kane blere truall dhe kane ndertuar godina te reja me kushte dhe sistemime shume me te mira se godinat e marra me qera, per te cilat eshte dashur nje pune dhe fonde te medha per tu pershtatur e per tu akomoduar si mjediset ne te cilat mund te zhvillohet mesimi. Keto truaje dhe godina te reja jane pozicionuar kryesisht ne zona periferike te

- **ADMINISTRATORET**

Administratoret e shkolles jane shfaqur qe ne fillim te krijimit te shkollave dhe ata kryesisht ishin pronaret ose njerëz shume te afert me to. Fillimisht fuqia ekzekutive e tyre ishte shume e madhe mbi cdo aspekt te ecurise se institucionit si ai ekonomik ashtu edhe ai edukativ. Kjo per faktin se ata ishin dhe **jane ende investitoret e pronaret e vetem** te ketyre shkollave. Me vone u shfaqen edhe drejtuesit pedagogjik “**drejtori i shkolles**” te cilet merren kryesisht me organizimin e procesit edukativ.



Zyrat e drejtueseve te shkollave jo publike jane te paisura me se miri

Sot ende ndihet fuqishem influenza e administratoreve ekonomike te shkolles ne te gjitha proceset ekonomike dhe edukative pamvaresisht se roli i drejtuesve edukative ka ardhur duke u forcuar ndjeshem. Kete fenomen keto institucione do e vuajne per kohe te gjate mbasi ne sistemin jo-publik nuk ka lindur akoma nocioni i subvencionit te pjesshem nga shteti i cili zbut deri

ne nje fare mase shthurejt e detyruara dhe te influencuara nga investitoret te udhehequr nga deshira per fitim te madh dhe rikuperim te shpejte te investimit te tyre. Ku ndihet kjo po japim nje shembull shume shkolla kane laboratore kimie por perdorimi i tyre eshte inefektiv mbasi ato kane nje konsum te madh kimikatesh dhe epruvetash te ndryshme keshtu mesuesit nga presioni i administratoreve per ulje konsumi apo mos demtim te epruvetave e paisjeve te ndryshme i bien shkurt duke ulur perdorimin e laboratoreve. Rastet me flagrante jane nderhyrjet ne kalushmerine e nxenesve keshtu per mesuesit nxenesi nuk duhet te kaloje klasen ne baze te rezultateve te dobeta qe ai ka patur gjate vitit kurse per administratorin nxenesi ka paguar tere vitin dhe e meriton te kaloje ne kete debat gjithmone fiton mendimi i administratorit me ane te vetos qe ai ka per marrje vendimi.

- **TRUPA PEDAGOGJIKE**

Ne fillim shkollat e para kishin kryesisht trupa pedagogjike me kohe te pjeseshme, ralle ndonje mesues definitiv ndonje pensionist apo qe kish ngelur pa pune. Kete raport e diktonin disa arsye. Kjo per vete faktin se a)ne fillim askush nuk donte te rrezikonte te linte punen e sigurt ne sektorin shtetor e te riskonte ne nje sipermarrje te ciles ende nuk i dukeshin rezultatet. Nje fenomen i tille demtonte disi imazhin e shkolles si dhe procesin e mesim dhenies pamvaresisht se mesuesit mund te ishin perzgjedhur nga me te miret. Me tej per eliminimin e ketij fenomeni nderhyri ministria e arsimit dhe shkences me ane te nje urdherese ne vitin 2001 ju kerkonte institucioneve te

edukimit jo-publik per te punesuar definitivisht mesues te pakten deri ne masen 60%. Nje urdherese e tille nuk pati efektivitet dhe nuk gjeti zbatim mbasi ishte dicka e pamundur per shkollat jo-publike te benin nje ndryshim te tille te trupes pedagogjike. **b)**Gjithashtu menytrat e pageses se mesuesve definitiv me ata me kohe te pjeseshme ndryshonin shume keshtu definitivet marrin deri 30-40 mije leke ne muaj plus siguracionet ndersa mesuesit me kohe te pjeseshme marrin mesatarisht 450-700 leke per ore mesimi qe i bie per nje 10 ore ne jave mesatarisht qe eshte me pak se gjysma e normes se mesuesit definitiv marrin 22-27 mije leke ne muaj. Te gjitha diferencimet vijne si rezultat i vleresimit te njohurive te mesuesve dhe cikli ku ata bejne mesim si dhe angazhimi i tyre ne kohe e parapregatitje. **c)**Ende edhe sot nuk eshte krijuar ndonje diferencim shume i madh ne motivim per mesuesit e mire midis sistemit publik e jo-publik qe te mund te kemi nje fludim te tyre drejt ketyre te fundit.

Sot po vihet re nje fenomen i tille plot shkolla jo-publike po mundohen te krijojne staf definitiv me mesues me moshe te re te cilet do te jene me te qendrueshem per te ardhmen e shkolles se tyre. Gjithashtu edhe pagesa e tyre me forma te ndryshme stimulohet nga perfshirja ne aktivitete apo angazhimi ne studimet e mbasdites dhe shkon 40-50 mije leke ne muaj.

Raporti i mesuesve definitiv me ata me kohe te pjeseshme ne shkollat jo-publike eshte ende i dobet vetem 20-30 e trupes pedagogjike eshte definitive ne shkolle. Kjo per dy arsye **a)**investitoreve ju intereson te kene mesues jo-definitiv mbasi per ta nuk paguajne asnje siguracion apo taks **b)**kerkesa e Ministrise se Arsimit dhe Shkences nuk eshte rigoroze dhe me sanksione per mos plotesim te ketij kushti.

- **NXENESIT**

Nxenesit ne shkollat e sistemit jo publik vijne nga sistemi publik dhe pak jane ata qe fillojne direkt nga e para ne kete sistem. Zakonisht ne keto shkolla nxenesit jane me **uniforma** te cilat kane nje tregues per shkollen e tyre nje gje e tille zakonisht eshte logoja e shkolles.



- **KURRIKULAT**

Ndryshime po behen edhe ne kurrikulat qe ofrohen. Pervec **kurikulave te miratuara nga MASH**, shume shkolla po perpiqen te ofrojne kurrikula edhe ne drejtime te cilat nuk ofrohen ne standartete e sistemit publik. Te tilla mund te permendim **kurrikulat e mesimit te gjuhes se huaj per anglisht, frengjisht, gjermanisht dhe spanjisht** jane krejtesisht **te reja** dhe te mara nga jashte shtetit, kurrikulat e ores se **baletit, notit, muzikes** (ne vegla te ndryshme muzikore) jane krejtesisht me nocione te reja, kurrikulat e edukimit


te **Informatikes** gjithashtu jane teper te avancuara krahasuar me ato te shkollave publike.

- **LABORATORET DHE MJETE DIDAKTIKE**

Ne sistemin e edukimit jo publik ndihet shume paisja e tyre me laboratore dhe mjete didaktike te metodave te fundit. Ne sistemin parashkollor keto jane plotesisht efektive te larmishme dhe te perdoreshme si nga edukatoret dhe nga femijet procesi edukativ zhvillohet ne menyre interaktive. Ne shkollat e sistemit tetevjecar shikohet perdorimi i tyre kryesisht ne **laboraret e gjuheve te huaja, te biologjise, fizikes** si dhe ka **mjete didaktike per gjeografine, arithmetikes**.

Ne shkollat e sistemit te arsimit te mesem ka

laboratore te **kimise, fizikes, biologjise** mjete didaktike te tilla si harta **gjeografie, astronomie, projektore**, etj. Por perdorimi dhe pajimi i tyre



Mjete didaktike te larmishme

lakmuset me nje perdorim, **boje printeri, boje fotokopje**, etj blihen me me veshtiresi.

ende **nuk ka hyre ne eficnce te plote**.

Kjo ka te beje me konsumin e tyre dhe investimet mbi to. Investimet mbi mjetet fikse per laboraret dhe me amortizim te ngadalshem behet me kollaj sesa per mjetet dhe paisjet me konsum me nje perdorim. Keshtu **kompjuterat, impjantet muzikore, hartat, librat, projektoret ekranet e projektimit** etj te ketij karakteri blehen kollaj, ndersa **kimikatet, epruvetat**

- **AMBJENTET E EDUKIMIT BRENDA SHKOLLAVE**

Nje vecanti e mire e sistemit te edukimit jo publik eshte dhe paisja me ambjente te ndryshme brenda shkolles per mesime speciale si te tilla mund te permendim **palestra** fiskulture te paisura me se miri, ambjente te hapura



sportive me regullsi maksimale ketu jane fusha **futbolli, basketbolli**, ambjente per mesimin e **dancit** salla te vecanta, ambjente per **studim** ne mbasdite, ambjente per **konsultime** mbasdite, **stendat** e ndryshme te bukura mbi aktivitetet e zhvilluara historikun e shkolles apo edhe **kalendare** mesimore e aktivitetesh. **Biblotekat** neper keto shkolla kane nje kutim me ndryshe se sa ne shkollat e sistemit publik. Ato jane te

pasura me libra e **literature** te koheve te fundit. Ne keto shkolla sheh nje sistem **gjelberimi** ne te gjitha ambjentet e brendeshme dhe te jashteme te shkolles.

- **AMBJENTET E SHERBIMIT TE NXENESVE DHE MESUESVE**

Ne keto institucione gjendet gjithmone nje sistem sherbim me teper dhe shume i rregullt krahasuar me shkollat e sistemit publik. Ne disa prej tyre ka **mensa** apo edhe ne ndonje rast ndonje **klub** ku femijet mund te hane dicka gjate periudhes se qendrimit ne shkolle. Disa shkolle kete sistem e kane ne forme mense qe e shoqerojne me pagesa te rregullta disa e kane ne forme klubi ku sherbimi eshte sipas nevojës. Sistemi i **tualetit** ne te gjitha shkollat eshte i persosur pastertia e tyre eshte nje nga ceshtjet qe preokupon e ndiqet ne menyre dinamike nga stafi i sherbimit. Ambjentet rethues **shlodhese** neper shkolle jo-publike jane me gjelberim dhe me bollek. Ne disa shkolle ka edhe **konvikte** per nxenes qe jane larg me vendbanim. Ambjentet e Konviktit jane pastra dhe komode. Dhomat jane per dy nxenes. Ne cdo shkolle ka nje **salle mesuesish** ku mblidhet edhe keshilli pedagogjik. Po keshtu ka edhe nje salle ku mblidhet keshilli i nxenesve **“parlamenti rinor”**.

- **STAFI I SHERBIMIT DHE SIGURIA**

Zakonisht ne shkollat e ketij sistemi ka nje staf sherbimi i cili kryen funksione te ndryshme dhe te percaktuara mire. Keshtu stafi kryesor eshte ai i **sigurimit** te nxenesve pra ne keto shkolle ka nje sistem rrojesh 24 oresh te cilet shpesh jane dhe polici e licensuar. Ky staf varet nga shkolle por qe zakonisht jane kater vete. Ky lloj stafi eshte permanent ne shkolle.

Sekretaria e shkolles ka nje sekretare e cila ben te gjitha veopimet e regjistrimit dhe arshivimit te aktivitetit te te gjithes shkolles.

Ne stafin e sherbimit jane edhe **shoferet** e transportit te nxenesve cdo dite nga shtepia ne shkolle dhe anasjelltas. Ky staf ne pjesen me te madhe eshte me kohe te pjeseshme dhe pak jane te perhershme ne shkolle.

Ne shkolle mbahet edhe nje staf per **pastrimin** dhe higjenen keta jane gjithashtu te perhershme ne shkolle.

Nje aneks me vehte eshte edhe prezenca e **mjekut** qe pergjigjet per shendetin e femijeve. Gjithastu ne shume prej shkollave ka edhe nje kend **dentisti**.



Me vehte jane edhe stafi i menses **guzhinjere** dhe **kamariere** edhe keta jane te perhershme ne shkolle. Ne disa shkolle klubi si aktivitet mund te jete edhe i rentur nga shkolle por qe zakonisht eshte si aktivitet i perbashket me shkollen. Ne cdo shkolle ka nje staf per **mirembajtjen** dhe problem te ndryshme

teknike qe eshte nje ose dy vete ne shkollat me ambjente te medha ka edhe bahcewane.

2.3 Forcat e tregut te sektorit te aresimit

I gjithë tregu i shkollave jo-publike është duke u strukturuar dhe qartësuar në baze të pranishme të një sërë elementesh të cilat duke bashkevepruar me njëri-tjetrin përcaktojnë edhe profilin aktual të këtij sektori në vendin tonë. Ato janë:

2.3.1 Shkollat jo-publike- fuqia e tyre

Aktori kryesor në këtë sektor janë vete shkollat jo-publike të cilat po avantazhojnë çdo ditë e më shumë në raport me shkollat publike. Këta aktorë në sektorin e aresimit po përpiqen të plotësojnë gjithë tregun e pakënaqur nga sektori publik aktual i cili ekspozon një sërë problemesh të cilat pjesa më e madhe reflektohen direkt tek konsumatori. Në bashkë me shumë ndryshime që shoqëruan vendin tonë gjatë viteve '90 edhe sistemi aresimor u prek dukshëm nga efektet e ndryshimeve. Por nga ana tjetër shumë individë të perkushtuar ndaj një aresimi cilësor, duke parë rritjen e cilësive në shkollat publike filluan të kenë pretendime më të larta kundrejt këtij shërbimi. Kjo solli kanalizimin e kërkesave të këtyre individëve drejt shkollave private, të cilat fillimisht ishin të vogla dhe me kapacitete të kufizuara. Me kalimin e kohës filloi të rritej akoma më shumë kërkesa për to dhe paralelisht edhe vete shkollat u rriten në shumë dejetime.

Shkollat jo-publike edhe pse të shumta në numër mund të konsiderohen si subjekte me fuqi ndikuese mbi konsumatorin, pasi edhe pse kërkesa për to është shumë e madhe ato janë në gjendje të përcaktojnë në mënyrë të pavarur çmimin për shërbimin që ato ofrojnë, pra pa u ndikuar fare nga konsumatori. E gjithë kjo ndodhë pasi kërkesa për shërbimin e ofruar nga këto subjekte është shumë herë më e madhe se sa oferta në këtë sektor.

Ndër faktorët më të rëndësishëm që i bëjnë këto shkolla konkurruese kundrejt atyre publike po përmendim:

- Mësues të përvojshëm dhe me eksperiencë.
- Motivimi më i mirë i stafit pedagogjik
- Procesi edukimit brenda shkolles më i mirë
- Numër i kufizuar nxënësish në një klasë max 16-20 nxënës
- Rregull i padiskutueshëm për orarain e mësimit dhe mbajtja e nxënësve brenda institucionit për gjithë kohën.
- Ambjente më të regullta dhe të pastra.
- Siguria e nxënësve.
- Transportim i sigurt i nxënësve nga shtëpia në shkollë e anasjelltas.
- Disa kurrikula dhe aktivitete shtesë gjatë vitit.
- Kanë një sistem promocional.

2.3.2 Zevendesuesit -Shkollat publike

Element tjetre i rendesishem ne kete sektor padyshim qe mbeten shkollat publike. Mund te thuhet se ka nje ndarje te qarte dhe te dukshme midis tregjeve dhe ofertave te te dy tipeve te shkollave. Kuptohet qe shkollat jo-publike terheqin ato konsumatore qe pervec pretendimeve kane edhe buxhetet e pershtateshme per te mbajtur nje femije ne nje shkolle private. Ndersa shkollat publike natyrisht qe terheqin pjesen derrmuese te popullsisë perderisa sherbimi aty eshte krejtesisht falas.

E megjithate edhe ky aktor ne kete treg mund te thuhet qe eshte i fuqishem dhe do te mbetet i tille edhe ne te ardhmen per disa arsye si: **(1)** sepse terheq pjesen me te madhe **(2)** kane shtrirje gjeografike te madhe, **(3)** trashegon nje infrastrukture dhe nje pronesi te jashtezakonehme **(4)** sepse prane shkollave publike ka mesues shume te mire, te pergatitur dhe me shume eksperience pedagogjike **(5)** sepse pavaresisht se numri i shkollave private eshte rritur mjaft, edhe pse prinderit paguajne para per aresimimin e femijeve te tyre, shpesh ne keto tipe shkollash ka vend edhe per abuzime, pasi per te joshur klientelen nga keto shkolle, ndoshta me rregulla te pashkruara mund te rezultojne edhe nje cilesi apo kalueshmeri fiktive, e cila ndoshta mund te demtojte jo vetem klientin por edhe imazhin e vete shkolles. Ne kete rast shkollat publike nuk mund te konsiderohen krejtesisht zevendesues pasi ne rast se nje prind ka provuar nje eksperience me nje shkolle jo-publike , tentativa e tij nuk do te orientohet drejt shkolles publike perkundrazi, perseri ky prind do te synojte nje shkolle tjere jo-publike.

2.3.3 Hyresit e rinj.

Duke qene se behet fjale per aresimimin , familjet e konsiderojne ate si investimin me te mire per femijet e tyre dhe ne kete kontekst ndonjehere nuk merren fare parasysh shumatat qe nje familje duhet te paguaje per te mbajtur nje femije apo nje te ri ne shkolle. Njekohesisht meqenese kerkesa per sherbimin e shkollave private eshte ne rritje, ky fakt ben te mundur edhe ekspozimin e shkollave private egzistuese ndaj nje kercenimi evident sic eshte hyrja ne kete treg e konkurrenteve te rinj. Barrierat e hyrjes ne kete sektor (licensat, kapitalet fillestare, investimet)nuk jane te pamundura, nderkohe qe ate qe mund te ofroje nje shkolle private mund ta ofroje edhe nje tjeter. Keshtu qe nje pjese e tregut te shkollave jo-publike do te sherbehet edhe nga konkurrente te rinj. Deri ne kete moment shkollat egzistuese private operojne te pavarura ne drejtim te hartimit te politikave te cmimit. Kjo gje duket edhe nga cmimet shume te variueshme neper shkolle te ndryshme qe nga cmimi 13 mije leke ne muaj deri ne 450 Euro ne muaj apo ne disa raste te vecanta edhe 900 euro ne muaj. Por situata nuk mund te qendroje pergjithnje e tille. Hyresit e rinj kuptohet qe per te justifikuar kostot e hyrjes do te perpiqen te aplikojne politika cmimi shume joshese duke bere te mundur nje fitim te pjeses se tregut ne kurriz te shkollave publike dhe atyre jo-publike. I gjithë sektori ne kete rast vihet ne levizje zinxhir te cilat dashur

padashur do te reflektohen edhe ne cmimet e ofruara per aresimin e nje femije apo nje te riu.

2.3.4 Klientet –fuqia e tyre.

Nje element tjetër i perfshire dhe aktive ne kete sektor jane edhe familjet apo prinderit e femijve apo te rinjve te aresimuar ne kete sektor. Shumica e familjeve qe kane nje apo dy femije per te aresimuar, pak a shume ndjekin te njejtin model per seleksionimin e shkolles me te pershtateshme per femijet e tyre. Ne radhe te para ata e kane shume te qarte diferencen midis nje shkolle private dhe nje tjeter publike keshtu qe koha me e madhe ne vendimarrje i kushtohet studimit dhe seleksionimit te shkollave private qe egzistojne ne treg. Merren kontakte te shumta me drejtues te ndryshem shkollash, studiohen nje sere elementesh, si vendodhja, sherbimet shtese (transporti, ushqimi, studimi, kushtet, cilesia e stafit pedagogjik, politikat dhe rregullat e shkolles) dhe natyrisht nje nder elementet me te rendesishem ne vendimarrje eshte cmimi. Asnjehere prinderit nuk kane fuqi te ndikojne mbi cmimet qe ofrojne shkollat nderkohe qe behet fjale per femijet e tyre dhe jo per nje mall konsumi te cilin po nuk u pelqeu cmimi nje here ata kane te drejte te mos e blejne me. Persakohe numri i shkollave private ne vend eshte ende shume i vogel ne raport me kerkesen e madhe te familjeve me femije, te gateshme te paguajne aresimin privat, fuqia e ketyre shkollave eshte shume me e madhe se sa ajo e konsumatoreve (ne kete rast femijet dhe familjet e tyre) perderisa keta te fundit jane te detyruar te pranojen ate qe u ofron momentalisht tregu. Aktualisht familjet qe mund te paguajne per shkollimin e femijeve te tyre jane familjet qe kane nje aktivitet privat apo kane nje rroge te mire shtetore. Kjo kupton nje te ardhur neto familjare reth 80 mije leke ne muaj. Familjet e punetoreve me rroga 20-30 mije leke ne muaj dhe te ardhura 40-60 mije leke ne muaj e kane te pamundur financimin e shkollimit te femijeve te tyre.

3.TREGU AKTUAL I SHKOLLAVE JO-PUBLIKE

3.1 Numri i shkollave jo-publike.

Sipas te dhenave te regjistrimit te fundit te popullsisë Census 2001, popullsia e Republikës së Shqipërisë rezultoi 3 069 275 banorë (te dhenat nga INSTAT) ku vetëm Tirana regjistroi një popullsi prej 519720 banorë. Duke marrë një koeficient rritjeje popullsisë rreth 1.3% në vit sot popullsia e vendit tone është 3180000 Banorë. Për këtë nivel popullsisë deri në vitin akademik 2003-2004 rezultojnë gjithsej 3784 institucione edukim publike nga të cilat 1678 kopshte, 1721 shkolla cikli i ulët (1-4 klase), shkolla të ciklit të lartë (5-8 klase), 1721 shkolla 8-vjeçare, 374 shkolla të mesme, dhe vërtet 11 shkolla të larta. Duke na cuar në një numër total nxënësish prej 757848 nxënës të të gjitha niveleve (duke përfshirë edhe ata parashkollorët).

Sot numërohen numërohen rreth 229 institucione jo-publike edukative me 25813 nxënës. Edukimi parashkollor ka 85 institucione që kanë 4151 fëmijë me 223 edukatore. Arsimi i detyrueshëm tërë vjeçar ka gjithsej 90 shkolla me 13553 nxënës dhe 1023 mesues. Arsimi i mesëm 51 shkolla nga të cilët 8 profesionale. Me 7704 nxënës nga të cilët 2077 në shkolla profesionale dhe me 722 mesues nga të cilët 174 për shkollat profesionale. Arsimi i lartë ka vetëm tre universitete aktualisht janë rreth 405 studentë dhe 54 pedagogë (keto shifra i perkasin vetëm dy universiteteve mbasi i treti është hapur vetëm tani dhe akoma nuk ka të dhëna të sakta). Universitetet janë vetëm në Tiranë. Një tabelë e përmbledhur edhe sipas shpërndarjes gjeografike të shkollave jepet më poshtë.

Shpërndarja e shkollave gjeografikisht jepet në grafiket pasardhës por vlen të theksojmë se Tirana përse i përket numrit të nxënësve përben rreth 43% të tyre. Këtu më poshtë po japim edhe disa lista të emërimit të shkollave të ndryshme kryesisht në Tiranë të ndara në shkolla për ciklin tërëvjeçar dhe për ciklin e shkolle së mesme.

Nr	Emertimi	Nxenes	Nr	Emertimi	Nxenes
1	Mehmet Akif Djem	254	12	Gjergj Kastrioti	
2	Mehmet Akif Vajza	263	13	Willson	65
3	Turgut Ozal	255	14	Mrekullia	6
4	SAADI	80	15	Vellezerit Frasheri	
5	Nxenesit e Mesdheut	25	16	Isak Njuton	
6	Drita e Diturisë	80	17	Gete	
7	Vellezerit kajtazi	181	18	Global	221
8	Mesonjtorja XXI	84	19	Arberia	8
9	Kristal	122	20	DonBosko	466
10	Aristoteli	48	21	Harr Fultz	
11	Inkus	88			

*Emrat e disa shkollave të
mesme jo-publike viti 2003-2004
me numër nxënësish gjithsej*

Nr	Emertimi	Nxenes	Nr	Emertimi	Nxenes
1	Kristal	526	24	Viktor Hygo	66
2	Medrese	170	25	Drita e se Ardhmes	51
3	Fenix	164	26	Europa	91
4	Turgut Ozal	936	27	Rruga e Dijes	
5	Udhe e Shkronjave	111	28	Motrat Qirjazi	143
6	Reze Drite	272	29	Progres V	58
7	Ylber	196	30	Hap pas Hapi	
8	Arsakeo	328	31	Iliria	74
9	Univers	131	32	Udha e Diturise	
10	SOS	293	33	Emanuel Kant	45
11	Drita e Diturise	124	34	Nen Tereza	
12	Gjergjim Qirjazi		35	Fokus	47
13	Willson	455	36	Tirana	
14	11 Janari	117	37	Mrekullia	63
15	Arberia	139	38	Vatra e Diturise	
16	Horizonti	48	39	Vellezerit frasheri	
17	Mesonjtorja XXI	91	40	Drita	14
18	Ditura	82	41	Eureka	94
19	E Ardhmja	41	42	Dritero Agolli	45
20	M.T.Bukuria	105	43	Protagonistet	55
21	MIST of Tirana	50	44	Shekulli	29
22	Delfinet e Vegjel		45	Flabina	57
23	Vellezerit Kajtazi	340			

*Emrat e disa shkollave te tetevjecare ne Tirane jo-publike
viti 2003-2004
me numer nxenesish gjithesej*

Nr	Rethet	Arsimi Parashkollor			Arsimi 8 vjeçar			Arsimi Mes. Përgjith			Arsimi Profesional		
		Kopshte	Femije	Edukatore	Shkolla	Nxënës	Mësues	Shkolla	Nxënës	Mësues	Shkolla	Nxënës	Mësues
1	Berat	2	121	5	2	218	17	2	257	28			
2	Bulqize		0	0									
3	Delvine		0	0									
4	Devoll		0	0									
5	Diber		0	0									
6	Durres	5	214	16	4	1282	73	2	355	38	1	211	22
7	Elbasan	3	341	14	4	578	37	1	68				
8	Fier	2	75	8	7	1225	61	4	744	54	1	102	17
9	Gramsh	1	12	1									
10	Gjirokaster	2	146	9	2	176	23	2	161	36			
11	Has		0	0									
12	Kavaje	1	74	3				1	156	19			
13	Kolonje		0	0									
14	Korce	1	80	5	1	132	10	1	125	15			
15	Kruje		0	0									
16	Kucove		0	0									
17	Kukes		0	0									
18	Lac	2	105	4	1	128	4						
19	Lezhe	4	223	9	3	155					2	98	
20	Librazhd		0	0									
21	Lushnje	6	185	11	1	211	18	1	128	8			
22	Malesi e Madhe	2	126	9									
23	Mallakaster		0	0	1	15		2	66	6			
24	Mat		0	0									
25	Mirdite		0	0									
26	Peqin		0	0									
27	Permet		0	0									
28	Pogradec	3	112	9	2	505	35				1	197	18
29	Puke		0	0									
30	Sarande	2	207	13	1	76	9	1	56	6			
31	Skrapar		0	0									
32	Shkoder	6	599	22	10	1895	113	4	974	125			
33	Tepelene		0	0									
34	Tirane		0	0	2	350	34						
35	Bashkia Tiranes	35	1124	65	45	5800	547	17	1889	169	3	1469	117
36	Tropoje		0	0									
37	Vlore	8	407	20	4	807	51	5	648	44			
	Republika	85	4151	223	90	13553	1032	43	5627	548	8	2077	174

3.2 The organizational structure of non-public schools.

If, we have a look on organisational structure of different level non-public schools, we come in conclusion that, their organograms are more or less the same and do not face any considerable changes.

Full activity is an entrepreneurship type “school owner”. In most of the cases the owners are individuals, who have invested their money and make profit through activity generation, as well as distribute dividends. Meanwhile, the management of these schools is separated from the ownership. In general in top level of these schools are two directors with clear responsibilities.

One of the directors is responsible for the program itself, and take care of the operational of the educative program. The director coordinates the all teachers tasks and measures the performance of each of them. The measurement should be made based on the results of the students at each end year.

In parallel with the first director is another one considered administrative director who takes care about administrative tasks of the school. This director is fully responsible for other tasks in school except the program delivery. So, He is responsible for people that work in finance and archival departments, internal services that school offers, such as transport of the students, internal environment management, food and accommodation, (is been talked here for schools that provide food for students) etc.

As for the program directors of non-public schools and kindergartens, we can say that all have high educational level. The majority of them are Albanian citizens with high reputation rate in education field. Very wellknown names run this kind of schools such as: Marenglen Spiro of “Kristal” school, Musa Kraja of “Mesonjetorja XXI” school who is owner and program director in the same time, Jetmir Alickaj of “Willson”, Dritan Spahiu of “I.Njuton” school, Fatmir Vejsiu of “Vellezerit Kajtazi-Tirana” school, Pranvera Hackaj of “Drita e Diturise” school, Shaban Sinani of “Saadi” school, Gezim Hado of “American Global High School”, Lydra Bicoku of “Flabina”, Gramoz Pashko of “New York University”, etc.

3.3 Pedagogical Personnel

The pedagogical personnel is understandable that is qualified preselected and tested. The trend of non-public schools is that they select the best teachers in order to realise their mission. So the recruitment process and human resource development is very crucial. A special phenomenon of non-public schools is that the directors during the running program, invite & integrate field personalities, who do not serve direct as teachers, but work in other important areas of life development. Meanwhile, the same thing should be done toward the motivation and the commitment of the teachers themselves. All we agree that the best motivation for pedagogical staffs is payment and other facilities created through a comfort environments, food or transport coverage.

Mesuesit perzgjidhen nga fusha te ndryshme per realizimin e currikulave te ndryshme. Nderkohe qe nje pjese e mire e trupave pedagogjike ehste e punesuar part-time. Sipas te dhenave statistikore rezulton se ne shkollat jo publike pjesa me e madhe e mesuesve jane part-time dhe shume pak jane te punesuar me kohe te plote. Kjo ehste tipike kryesisht per shkollat e mesme. Shpesh pagesa nuk mjafton per te terhequr prane ketyre shkollave individe te kualifikuar te cilet jane te kerkuar ne tregun e punes dhe ndoshta jane te punesuar diku tjeter. Ne keto raste keta mesues eshte shume e veshtire qe ti punesosh me kohe te plote pasi edhe pagesa qe do tu jepej do te ndikonte ne rritjen e kostove dhe per pasoje do te rriteshin cmimet e sherbimit. Nga ana tjeter ne treg (kryesisht ne tregun e Tiranës qe ka dhe peshen me te madhe ne kete sektor) po hyjne me shpejtesi aktore te tjere te cilet jane te gatshem te konkurrojne me cmime me te uleta. Ndaj zgjidhja qe i kane dhene keto shkolla ketij problemi eshte punesimi i personave te kualifikuar me kohe te pjeseshme dhe pagesa e tyre ne baze te oreve mesimore te zhvilluara krahas atyre te punesuar me kohe te plote.

Disa shkolla perdorin edhe politika fleksibel persa i perket preferencave per moshen e mesuesve. Keto shkolla mund te ndahen ne dy kategori: Shkollate qe kane mundesi te mira financiare dhe ato me te voglat qe nuk kane mundesi te medha financiare. Te parat (kuptohet kane edhe numer te madh nxenesish) preferojne te punesojne staf pedagogjik me kohe te plote moshe te relativisht te re. Kjo behet per te afruar individe energjike dhe te kualifikuar me qellim krijimin e nje stafi stabel qe do te jete nje mbeshetje e mire edhe per strategjite e rritjes qe kane hartuar shkolla te tilla. Gjithashtu keto shkolla parapelqejne te punesojne staf me kohe te pjeseshme me moshe relativisht te madhe ose meues me shume eksperience por qe kane dale ne pension. Kjo pasi keta individe mund te transmetojne tek femijet dhe te rinjte vlera nderkohe qe atyre nuk u paguhen pushimet e veres dhe sigurimet shoqerore.

Ndersa shkollat e tipit te dyte, ne pamundesi per te punesuar individe te rinj e te kualifikuar, preferojne te punesojne me kohe te plote personel ne mosha relativisht te medhaja.

Ne momentet e para te hapjes se shkollave jo-publike pjesa me e madhe e sfafit ka qene me kohe te pjeseshme dhe selektohej nder me te miret e me te kualifikuarit. Nje pjese e tyre vinin nga mjediset akademike te fakulteteve te ndryshme, te cilet terhiqeshin nepermjet pageses, por me kalimin e kohes kjo tendence u zbeh pasi nivelet e pagese per ore mesimi per keta mesues mbeten stabel, nderkohe pagesa nuk po justifikonte me vleren e nje ore mesimi si mesues me kohe te pjeseshme.

Persa i perket kombesise se stafit, ajo eshte kryesisht shqiptare, por ne disa raste ka edhe shkolla me mesues e drejtues te huaj. Keta te huaj duhet te kene leje banimi ne Shqiperi, e marre kjo prane organeve kompetente ne perputhje me ligjin , gje e cila duhet ti bashkangjitet dokumentacionit shkollor.

3.4 Raporti student / mesues

Nje problem evident dhe i diskutueshem kohet e fundit eshte edhe raporti mesues nxenes i cili lidhet ngushtesisht me madhesine e nje klase mesimi. Nga te dhenat e MASH per vitin akademik 2003 rezulton se per shkollat publike te sistemit 8-vjecar

numri i pergjithshem i nxenesve ne nivel kombetar eshte 491 541 nderkohe qe numri i pergjithshem i klasave eshte 20453 klasa (nga te cilat 8181 klasa nga e para ne te katert , 8604 klasa nga e pesta ne te teten, 2595 klasa vetem per shkollat me 4 klase dhe 1088 klasa per shkollat e kombinuara). Pra mesatarisht ne sistemin 8-vjecar publik rezulton qe nje klase te kete 24 nxenes. Pra cdo mesues ne cdo ore mesimi mesatarisht ballafaqohet dhe punon me 24 nxenes. Por bazuar ne shperndarjen gjeografike te nxenesve dhe shkollave faktikisht ne tirane ne shkollat publike ka klasa me tridhjetete dhe dyzet nxenes

Nderkohe qe persa i perket sistemit 8-vjecar jo-publik numri i nxenesve varion mesatarisht nga 15-20 nxenes. Madje ne disa shkolla kjo mesatare eshte edhe me e ulet.

Ne sistemin e shkollave te mesme publike numri i pergjithshem i nxenesve qe vazhdojne shkollen me shkeputje nga puna eshte 118 361, ndersa numri i klasave eshte 2743, qe rezulton ne mesatarisht 43 nxenes per nje klase. Referuar arsytimit te mesiper si dhe bazuar ne shperndarjen gjeografike te nxenesve dhe shkollave faktikisht ne Tirane ne shkollat publike ka klasa me 50 pesedhjetete e 60 dhjetete nxenes.

Ne sistemin e shkollave te meseme jo-publik numri i nxenesve varion mesatarisht nga 15-20 nxenes per nje klase.

Numri i nxenesve per cdo klase ne sektorin e aresimit publik ehste matur dhe llogaritur ne nivel kombetar, por ne keto shifra ka vend edhe per pershtatje. Ne kete mesatare kane ndikuar edhe te dhena ekstreme te cilat jane regjistruar kryesisht ne shkollat publike ne rrethet qe kane numer popullsie me te madhe dhe dendesi me te madhe si edhe shkollat e fshatrave te cilat kane numer me te vogel nxenesish dhe klasash. Ne qytetet e medha vihet re nje rritje e numrit te nxenesve per cdo klase mbi mesataren e llogaritur. Psh. Ne shkollat 8-vjecare dhe te mesme te Tiranes, (sic e permendem edhe me siper) si pasoje e rritjes se shpejte te numrit te popullsisë keto vitet e fundit, klasta jane te mbipopulluara duke arritur ne 40-60 nxenes per cdo klase. Kjo mbetet problematike jo vetem per shkollat 8-vjecare por edhe per ato te mesme.

Nje nga problemet me kryesore qe vjen si pasoje e ketij mbipopullimi te klasave eshte pamundesia e nje mesuesi per te motivuar dhe kontrolluar te gjithë nxenesit brenda nje ore mesimore 35-45 minuteshe, nderkohe qe sa me e madhe klasa aq me shume kohe do te duhet per te bere apelin.

Gjithastu nje problem serioz eshte dhe siperfaqja e mesimit dhe numri i klasave te nje shkolle. Ne ato private nr i klasave eshte i mjaftueshem per 15-20 nxenes ne klase ndersa ne shkollat publike shpesh ka shkolla qe kalojne me dy turne nga denduria e madhe e nxenesve.

Keto perbejne edhe disa nga aresyet me kryesore pse shume prinder synojne sherbimin e ofruar nga shkollat jo-publike ne vend te atyre publike.

3.5 Burimet e financimit te shkollave

Nga vezhgimi nepermjet intervistimit te bere ne disa shkolla jo-publike rezultoi se shumica e shkollave jo-publike jane te financuara nga kapitalet e veta te sipermarresve perkates. Njekohesisht ka edhe shkolla qe jane financuar nga donime te ndryshme te komuniteteve me nje qellim te caktuar. Disa prej tyre jane me baze besimi shkolla per te cilat eshte veshtire te gjendet klientele per te paguar, komuniteti shqiptar ne amerik finacon per nje institut arsimor teknik ne shqiperi etj.

Ne vende te ndryshme te botes sistemi aresimor eshte privat por edhe financohet pjeserisht nga shteti. Ne disa vende masa e financimit eshte gati 50%, por ka edhe vende ne te cilat shteti arrin deri ne 80% te financimit dhe mbajtjes se shkollave jo-publike nj vend i tilleeshte Danimarka. Kjo flet per nje rendesi qe i kushton shteti politikave ne drejtim te aresimit. Njekohesisht nepermjet kesaj marredhenieje vete shteti ka mundeis te kontrolloje gjith performimin e ketij sektori.

Ne vendin tone deri para viteve `90 i gjith sistemi aresimor, ashtu si edhe cdo sherbim tjeter i ofruar publikut ka qene falas. Nderkohe qe pas viteve `90 vihet re fenomeni i hapjes se shkollave jo-publike, te cilat fillimisht nisen nepermjet kursimeve personale te sipermarresve. Gjithcka vazhdon e tille edhe sot. Sipermarresit e sukseshem qe kane krijuar shkolla te konsoliduara tashme dhe me reputacion e i mazh te mire ne treg, sot kane ndermarre strategji rritjeje, por perseri nepermjet financimeve te siguruara nga kapitalet e tyre ose nepermjet burimeve alternative si huate bankare etj. Por asnjehere te mbeshtetur nga shteti.

Nje nga mangesite kryesore qe evidentohet dukshem ne kete sektor eshte edhe mospjesemarrja e shtetit ne financimin e ketyre subjekteve. Kjo shpesh behet shkak per abuzime te cilat me shume jane ne dem te imazhit dhe reputacionit te shkolles dhe kryesht te klienteve (nxenesve dhe famijleve te tyre. Por nga ana tjeter lulezimi i sektorit te shkollave jo-publike paraqet edhe nje perfitim tjeter ne favor te shtetit . Buxheti i shtetit parashikon njne shume te caktuar qe do te investohet cdo vit per aresimin. Ne kete shume pershihen zerat : shkolla(ndertim dhe konstruksion), pajisje si banka, tavolina, karrike, laboratore etj, paga per mesuesit etj. Te gjitha keto zera duhet te mbulohen nga ajo pjese e buxhetit qe gjenerohet pikerisht nga te ardhurat e mbledhura nga taksat per aresim qe duhet te paguaje cdo qytetar. Nderkohe lulezimi i sektorit te shkollave jo-publike ben qe kjo pjese e buxhetit te shtetit mund te perdoret per permiresimin e sherbimit te ofruar nga sektori i shkollave publike, pra sa me shume te rritet sektori i shkollave jo-publike aq me shume para do te kete ne dispozicion per aresimin publik nga buxheti i shtetit.

3.6 Infrastruktura e shkollave jo-publike.

Nje nga avantazhet e shumta te shkollave jo-publike kundrejt atyre publike eshte pikerisht infrastruktura e tyre. Shkollat jo-publike, pothuaj shumica e tyre, jane dislokuar ne vende dhe pozicione te favoreshme per mesimdhenien.

Fillimisht keto shkolla u vendosen shume prane qendrave te banuar ne godina te blera ose te marra me qera, por qe megjithe perpjekjet per ti transformuar e per ti

bere sa me komode, perseri ato ishin shume te veshtira per tu adoptuar 100% ne ambjente te pershtateshme per nje skolle.

Me vone, kur keto shkolla u fuqizuan financiarisht, filluan edhe investimet e para per te blere truall e per te ndertuar godina komode dhe te organizuara mjaft mire per mesimdhenie.


Pjesa me e madhe e shkollave jo-publike ne Tirane jane te vendosura ne vende te vecuara nga qyteti, gje qe garanton eliminimin e nje qetesie totale large zhurmave te rruges dhe ndertimeve te ndryshme. Sipermarresit e tyre kane bere investime serioze ne ndertimin e godinave te pershtateshme me te gjitha ambjentet e duhura.


Pothuaj te gjitha shkollat jo-publike jane te pajisura pervec numrit te duhur te klasave edhe me salla dhe ambjente te tjera ne funksion te mesimdhenies te tilla si laboratore kimie, fizike, kompiuterash, biblioteka, palestra, dhoma muzike, laborator per te mesuar gjuhet e huaja, mensa, konvikte etj. Pervec ambjenteve me te domosdoshme, ne keto investime rendesi u eshte kushtuar edhe krijimit te mjediseve te tjera si mjedise shlodhjeje, lulishte, pishina, shatervane etj.

Cdo skolle ka nje objekt rethues e cila ben ndarjen e ambjenteve te brendeshme te territorit te shkolles nga ambjentet e jashteme.


3.7 Shperndarja gjeografike

Persa i perket numrit te shkollave per cdo rreth te vendit ato paraqiten ne faqen 10 te materialit, ndersa te dhena me specifike si psh ne lidhje me perqindjet e nxenesve sipas cdo skolle dhe sipas secilit sistem te shkollave jo-publike ne vendin tone paraqiten si vijon:






Shperndarja Gjeografike e Shkollave jo publie tetvjecare




- Berat
- Bulqize
- Delvine
- Devoll
- Diber
- Durres
- Elbasan
- Fier
- Gramsh
- Gjirokaster
- Has
- Kavaje
- Kolonje
- Korce
- Kruje
- Kucove
- Kukes
- Lac
- Lezhe
- Librazhd
- Lushnje
- Malesi e Madhe
- Mallakaster
- Mat
- Mirdite
- Peqin
- Permet
- Pogradec
- Puke
- Sarande
- Shkoder
- Tepelene
- Tirane
- Bashkia Tiranes
- Tropoje
- Vlore



**Shperndarja Gjeografike
e nr te nxenesve shkollave jo
publie tetvjecare**





**Shperndarja Gjeografike ne % e
Shkollave te Mesme Pergjitheshme**




Shpërndarja Gjeografike e nr te nxenesve
Shkollave te Mesme Pergjitheshme jo publike





Shpërndarja Gjeografike e Nxenesve te Shkollave te Mesme Profesionale



Shpërndarja Gjeografike e Nxënësve të Shkollave të Mesme Profesionale



Shpërndarja Gjeografike e Nxënësve të Shkollave të Mesme Profesionale



Duke shqyrtuar grafiket e mesiperm, pothuaj ne te gjithë rezultojnë se Tirana është rrethi me numrin më të madh të shkollave, numrin më të madh të nxënësve në të gjitha nivelet e sistemit arsimor jo-publik . Me pas në renditje vijojnë Shkodra me

11% te shkollave 8-vjecare,,Fieri me 8%, Vlore,Durres dhe Elbasan me 4% dhe me tej rrethet e tjera me perqindje me te vogel qe varion nga 1-2% te te gjithë tregut te shkollave jo-publike. Po keshtu pak a shume e njejta renditje qendron edhe persa i perket numrit te nxenesve te shkollave 8-vjecare jo-publike; Tirana me 5800 nxenes, Shkodra me 1895, Durresi me 1282, Fieri me 1225 dhe Vlora me 807 nxenes.

Persa i perket sistemit te shkollave te mesme Tirana renditet e para duke kapur e 40% te tregut me gati 1889 nxenes, Vlora qe ze 12% te tregut, Shkodra dhe Fieri me 9% e me radhe pastaj qytete e tjera qe zene mesatarisht 2-5% te tregut secila.

Ne lidhje me sistemin universitar nuk mund te flitet ende per shperndarje gjeografike pasi tregu ne kete drejtim eshte ende shume i ngushte dhe eshte i perqendruar vetem ne Tirane. Ne rrethe e gjithë kerkesa per studimet e larta permbushet nga universitetet e rretheve dhe nje pjese e mire e nxenesve preferojne te studiojne jashte kryesisht ne Itali.

3.8 Sherbimet shtese qe ofrojne shkollat jo-publike ne krahasim me ato publike.

Qe ne mometin e licensimit si shkolla jo-publike cdo shkolle duhet te paraqese edhe kurrikulat mesimore te cilat aprovohen dhe miratohen nga Ministria e Aresimit dhe Shkences , te cilat jane te njejta me ato qe perdoren ne shkollat publike.

Dallimi kryesor qe egziston midis ketyre dy sektoreve qendron pikerisht ne sherbimet shtese qe ofron sistemi i shkollave jo-publike.

Disa prej ketyre sherbimeve jane:

- Transporti – eshte nje sherbim qe pervec te tjerash josh shume prinder te zgjedhin sistemin jo-publik kundrejt atij publik. Rritja e shpejte e Tiranes ka bere qe transporti te shnderrohet ne nje stres te vertete per shume individe. Nderkohe qe shume prinder ne mengjes duhet te shkojne ne pune dhe pasdite ne momentin qe femijet duhet te kthehen nga shkolla ne shtepi, ata mund te jene akoma ne pune. Pothuaj te gjitha shkollat jo-publike ne paketen e sherbimeve ofrojne edhe transportin. Disa nga shkollat e bejne falas, ndersa disa te tjera kundrejt nje tarife mujore.
- Ushqimi – disa shkolla, psh. MIST(Memorial International School of Tirana). Ne kete shkolle, nxenesit pervec mesimit dhe aktiviteteve te tjera kane te ofruar edhe ushqimin ne te cilin perfshihet mengjesi ne 8.⁰⁰, dreka ne 12.⁰⁰ dhe “zemer” ne oren 14.³⁰.
- Konvikti- nxenesit dhe studentet qe vijne nga rrethet e vendit u sigurohet edhe konvikti .
- Aktivitete argetuese te tilla si shetitjet, ekskursionet, organizimi i festave , koncerteve, teatrove etj

- Edukimi fizik.- ky i fundit realizohet edhe ne shkollat publike por natyra, niveli dhe larmia e ketij edukimi eshte me dominuese ne shkollat publike. Kjo per faktin e thjeshte se duke pasur kapacitete e duhura dhe duke pasur shume me pak nxenes per cdo klase ehste me me mundur te realizohet ketu se ne shkollat publike. Shpesh ne shkollat publike mungojne palestrat dhe jo rralle edhe baza materiale per te realizuar oret e edukimit fizik.
- Sherbimi mjekesor. Pothuaj te gjitha shkollat jo-publike kane te punesuar te pakten nje mjek i cili merret me mbarevajtjen shendetesore te femijeve. Njekohesisht mjeku krijon edhe dosjen perkatese me te dhenat e shendetit te femijeve, qe per cdo rast i komunikohet edhe prinderve.
- Salla studimi- nxenesve u vihen ne dispozicion salla studimi duke u dhene mundesine keshtu qe pjesa me e madhe e detyrave te behen ne shkolle para se te ikin ne shtepi. Njekohesisht atyre u jepet mundesia edhe te konsultohen me mesuesin gjate kohes se studimit .psh. tek shkolla jo-publike “Drita e Diturise” ne seancat e studimit pas mesimit ofrohet konsulence nga mesuesi kundrejt nje pagese simbolike prej 100 lekesh te reja. E gjithë kjo behet per te shmangur konsultimet jashte mesimit (kurset) kundrejt nje pagese me te larte qe haset random ne shkollat publike.
- Stimuj te natyrave te ndryshme per nxenesit qe dalin me rezultate te larta ne mesime psh. shpesh u sponsorizohet viti vijues akademik, ose u behen sonto te ndryshme ne pagesen mujore, ose u dhurohen udhetime falas brenda vendit ose jashte etj.

3.9 Analiza e pikave te forta e te dobëta (Analiza SWOT)

Eshte mese e dukeshme kerkesa gjithnje e ne rritje per sherbime te ofruara nga shkollat jopublike. Ky sektor po vjen duke u rritur ne kurriz te shkollave publike te cilat ende jane dominuese ne treg dhe kane per te mbetur te tilla per nje kohe shume te gjate pasi jo te gjitha familjet kane mundesi financiare per te paguar sherbime te shtrenjta te ofruara nga sistemi jo-publik i aresimit. Dalengadale po fillojne te qartesohen pozicionet e te dy tipeve te shkollave duke u bere orientuese per te gjithë tregun.

3.9.1 Fuqite

- Shkollat jo-publike karakterizohen nga nje sherbim i mire e cilesor, qe justifikon edhe pagesen qe bejne klientet e ketij sistemi.
- Shkollat jopublike i kushtojne rendesi te madhe procesit te seleksionimit te stafit pedagogjik te kualifikuar dhe energjik
- Ofrojne sherbime shume me cilesore sesa shkollat publike
- Kujdesi dhe interesimi per femijet eshte shume me i madh
- Karakterizohen nga nje disipline me e mire pedagogjike dhe administrative

- Kane kapacitete fizike dhe intelektuale shume here me te mira se sa shkollat publike
- Arrijne te konkurrojne nepermjet imazhit qe kane krijuar ne treg
- Kane mundesi me te mira investuese ne drejtim te ambienteve te specializuara, baze materiale dhe laboratorike
- Kane politika promociionale me te mira se sa ne shkollat publike kundrejt nxenesve qe arrijne te kene rezultate te larta.
- Raporte dhe marredhenie me te mira mesues-nxenes (kjo favorizohet nga numri i vogel i nxenesve neper klasa). Nxenesit nuk kane stresin e notes dhe mesuesit jane me tolerante
- Numer i vogel nxenesish
- Sistem dy ose tre gjuhesh
- Informatika si lende e vecante qe ne shkollen 8-vjecare
- Sigurim i tipeve te ndryshme te bursave

3.9.2 Dobesite

Edhe pse ne dukje krejt perfekt edhe sistemi i shkollave jo-publike ka mangesite dhe anet e veta te dobeta te tilla si:

- Mospjesemarrja e shtetit ne burimet e financimit i le paksa jashte kontrollit keto shkolla duke u dhene mundesi keshtu edhe abuzimeve te mundeshme.
- Shpesh duke u mbeshtetur pas faktit qe nxenesit ne keto shkolla paguajne per tu aresimuar i detyron ndonjehere mesuesit te tolerojne me shume sec duhet qofte ne drejtim te vleresimit te dijeve, po ashtu edhe ne drejtim te sjelljes.
- Kane pagendrushmeri nxenesish, shpesh vihet re nje qarkullim i larte i nxenesve nga njera shkolle private ne tjetren.
- Mesuesit gjithashtu ndryshojne shpesh madje disa here brenda nje viti akademik
- Nuk u garantohet puna mesuesve, shpesh nuk u paguhen sigurimet shoqerore dhe punojne pa kontrata pune ne perputhje me kerkesat e ligjit
- Ne nje pjese te mire te shkollave jo-publike labororet sidomos ata te kimise gati nuk funksionojne fare, pasi puna ne to kerkon shpenzime te medha per baze materiale
- Ne disa raste (behet fjale per shkolla te vogla) mjediset jane te papershtateshme pasi godinat jane te vogla ose neper pallate, prane rruges dhe zhurmes.
- Baza ligjore eshte ende e paplote ne kete drejtim duke lene shteg ne kete menyre per veprime te paligjeshme, pasi nuk ka sanksione te forta. Egziston vetem nje ligj per statistikate qe ka sanksione, edhe ato me vlere te vogla gjobe dhe te padetajuar ne ligj se kush e ka te drejten e vjeljes se takses
- Fshehje e te ardhurave dhe fitimit per ti bere bisht detyrimeve fiskale

3.9.3 Kercenimet

Konkurentet dhe kercenuesit jane te ndryshem

- Kercenuesi kryesor i shkollave jo-publike ne vend jane kryesisht hyresit e rinj, te cilet duke pare se barrierat e hyrjes nuk jane shume te larta, dhe perfitimet jane te mira, padyshim qe do te tentojne te hyjne ne kete sektor fitimprures. Njekohesisht duke pare edhe gjendjen aktuale te shkollave jo-publike dhe kerkesen gjithnje ne rritje per sherbime te ofruara nga ky sektor, mund te thuhet se hyrja ne treg e konkurrenteve te rinj eshte e pashmangeshme. E gjithë kjo do te coje ne ripozicionime te shpesta te shkollave aktuale, te cilat do tu duhet te fillojne te sherbejne akoma me mire nepermjet avantazheve konkurruese qe do tu duhet te fitojne per te mbajtur te pacenuar pjeset e tregut qe ato zoterojne aktualisht.
- Kercenim per shkollat jo-publike perbejne edhe konkurentet ne sektor te cilet mund te kercenojne me elkementin me te prekshem ne kete fushe sic eshte cmimi. Kercenim mund te perbeje fakti qe nje nxenes duke levizur nga nje shkolle ne tjetren mund te behet shkak per ekspozimin dhe imitimin e politikave dhe procedurave qe ka secila shkolle dhe qe mund te jene avantazhe konkurruese per te.

3.9.4 Shanset


- Ky lloj sistemi edukimi eshte nje sherbim i ri ne treg dhe kerkesat per te jane te medha.
- Imazhi i mire qe sollen dhe vazhdojne te shfaqin shkollate e huaja per sistemin jo-publik perbenete nje shtyese per rritjen e tregut te klienteve per kete lloj sherbimi.
- Anetaresimi i Sistemit Univeristar ne Kartene e Bollonjes do te ndikojë ne rritjen dhe permiresimin e cilesise ne te dy sektoret si ate publik dhe ate jo-publik.

3.10 Tendenca e tregut

Per vitin 2003-2004 ashtu sic shihet edhe ne tabelen e mesiperme rezulton se ne total numri i subjekteve te aresimit privat ne rang Republike eshte 229 pra 117 shkolle private me shume ne krahasim me vitin akademik 2000-2001. nga ky total rezultojne gjithsej 85 kopshte me nje numer prej 4151 femije nga te cilet 35 kopshte rezultojne vetem ne Bashkine e Tiranes me nje numer prej 1124 femijesh. Nderkohe qe numri i shkollave 8-vjecare ka arritur ne 90 me 13 553 nxenes nga te cilat numerohen 45 shkolle private 8-vjecare vetem ne Tirane me gati 5800 nxenes te regjistruar pra **22 shkolle dhe 2300 nxenes me shume** ne krahasim me vitin 2001. Po keshtu rritje te dukshme ka pasur edhe ne numrin e shkollave te mesme te pergjitheshme dhe profesionale si dhe ne numrin e nxenesve ne to: pra 43 shkolle te

mesme te pergjitheshme dhe 8 shkolla profesionale ne te gjitha vendin nga te cilat 17 shkollat te mesme te pergjitheshme dhe 3 te mesme profesionale jane ne Tirane dhe regjistrojne ne total nje numer nxenesish prej 3358 (perkatesisht 1889 ne shkolle te mesme te pergjitheshme +1469 ne shkolle te mesme profesionale). Ne total regjistrohet **nje rritje me 29 shkolla te mesme te pergjitheshme dhe profesionale se bashku me nje rritje nxenesish prej 3716** ne raport me vitin 2001 dhe nga kjo shifer shkolla te mesme(profesionale dhe te pergjitheshme) jane shtuar vetem ne Tirane me nje numer nxenesish prej 2058 vete.

Pra nga sa vihet re me sipër rezulton se midis periudhes 200-2001 dhe 2003-2004 kemi nje rritje te konsiderueshme te numrit te shkollave te te gjitha sistemeve dhe te numrit te nxenesve te regjistruar ne to e matur kjo me numrin e pergjithshem te popullsisë te perfshire ne intervalet moshore te prshtateshme per tu aresimuar.



702 000 banore. Rritja totale do te jete jo me pak se + 158 000 dhe jo me shume se +659 000 banore. Ne krahasim me pjesen tjeter te popullsisë se Europes popullsia e Shqiperise mund te konsiderohet popullsi "e re "(ne moshe te re) pra me nje proporcion te larte te njerezve nen 15 vjec dhe me proporcion te ulet te njerezve te moshuar mbi 65 vjec. Ne intervalin e ardhshem kohor kjo specifike mund te zbehet disi duke cuar ne renie te njerezve te rinj dhe rritje te proporcionit te me te vjterve. Megjithate duke mbetur perseri tek qellimi i ketij studimi te dhenat e projektuara jane ende optimiste.

Duke mbetur perseri tek te dhenat e MASH per numrin e shkollave jo-publike dhe nxenesve te regjistruar ne to vihet re gjithashtu edhe nje shperndarje jo normale e tyre ne rang vendi.

Kuptohet ne vend te pare renditet Bashkia e Tiranës dhe me pas vijne rrethe te tjera sipas renditjes Shkodra me 10 shkolla 8-vjecare dhe 4 shkolla te mesme; Fieri me 7 shkolla 8-vjecare, 4 te mesme te pergjitheshme dhe 1 te mesme profesionale; Vlora me 4 shkolla 8-vjecare dhe 5 te mesme te pergjitheshme; Durresi me 4 shkolla 8-vjecare, 2 te mesme te pergjitheshme dhe 1 te mesme profesionale. Dhe me pas vijne rrethet e tjera me mesatarisht 3 shkolla jo-publike. Edhe pse norma e rritjes se popullsisë ne vendin tone deri ne vitin 2021 do te jete dicka me e ulet se ritmet e

mepareshme te rritjes, perseri mund te vihet re se numri i shkollave jopublike ne vend do te vije duke u rritur.

Vendi yne eshte nje vend ende ne kushtet e nje tranzicioni dhe shenon nje norma papunesie gati 14.8 (burimi INSTAT). Kryesisht pjesa me e madhe e te papuneve jane te rinjte deri ne moshen 28 vjec. Norma e papunesise eshte nje tregues qe korrelohet ne menyre te zhdrejte me numrin e te aresimuarve, pasi norme e larte papunesie shoqerohet me nje kosto te ulet oportune te vazhdimet te shkolles se larte. Deri me sote aresimimi i larte ka qene dominuar nga ai shteteror pasi edhe ka pasur tarifat me te uleta (gati falas) per cdo student. Kjo ka bere qe nga viti ne vit norma e rritjes se te pranuarve neper universitetet e vendit te jete rritese. Gjithashtu fakti i te pasurit te nje diplome universitare rrit shanset per tu punesuar dhe nepermjet punesimit, sigurimit te nje jetese me te mire.

Ne kuadrin e reformave ne aresimi sistemi universitar po fillon te ndryshoje, gje qe reflektohet ne kurrikulat e reja qe po futen dhe ne teknikat e reja te mesimdhenies. Nga ana tjeter perpjekjet per reformim ne shkollat e mesme dhe ato 8-vjecare ecin me ritme me te uleta zhvillimi gje qe detyrimisht con ne krijimin e nje hendeku te konsiderueshem midis asaj qe aktualisht po ofrohet ne shkollat e larta dhe kapaciteteve qe vijne nga shkollat e mesme. Problemi nuk mbetet vetem tek mangesite e shkolles se mesme, pasi keto jane derivat i drejteperdrejte i sistemit aresimor 8-vjecar. Pra behet fjale per nje proces zinxhir qe fillon qe ne aresimin e hershem dhe qe jep ndikimet e veta ne gjithe formimin e nje te riu derisa ky i fundit del produkt i gatshem per tregun e punes. Kuptohet qe i gjithe zinxhiri te funksionoj, duhet qe nderhyrjet te behen qe ne hallkat e para. Kjo eshte dhe nje nga aresyet kryesore qe shtyjne shume familje qe te investojne per formimin e femijeve te tyre qe kur ata shkojne ne shkolle 8-vjecare duke i regjistruar ata ne sisteme jo-publike qe deri me sot rezultojne te jene me cilesore se shkollat publike.

Fillimisht iniciativa e aktiviteteve te tilla private nisi ne Tirane , ku edhe popullsia eshte me e madhe por edhe ketu eshte perqendruar pjesa e familjeve me te ardhurat mesatare me te larta per fryme dhe ne gjendje per te aresimuar ne menyre private femijet e tyre. Pervet te tjerash popullsia ne Tirane eshte shume here me e familjarizuar me konceptin e te aresimuarit te femijeve ne nje shkolle private se sa popullsia e rretheteve te tjera (kete fakt e mbeshtet edhe vete numri shume i madh i shkollave private ne kryeqytet) dhe dalengadale, ky fakt po kthehet ne norme per ate kategori familjesh qe eshte e afte financiarisht te suportoje sherbime te tilla per femijet e tyre.

Gjithashtu nga te dhenat rezulton se aktualisht numrin me te madh te shkollave private e kane rrethet me popullsi dhe me dendesi me te madhe te tilla si Fieri, Durresi, Vlora, Elbasani, Shkodra etj.

Pjesa me e madhe e rretheteve dhe qyteteve te vendit ende nuk rezultojne te kene sipermarrje te shkollave jo-publike, keshtu qe nje pjese e mire e tregut nese do te behej nje shperndarje normale e te gjitha shkollave aktuale ne te gjitha vendin do te rezultonte qe te kishin te pakten 2 kopshte private, gati 2 shkolla te sistemit 8-vjecar, dhe te pakten nga nje shkolle te mesme.

Megjithate dihet fare mire korrelacioni pozitiv qe egziston midis numrit te shkollave dhe numrit te nxenesve, keta te fundit jane derivat i numrit te pergjithshem te popullsise se nje rrethi dhe i dendesise perkatese. Perpjekja per te parashikuar na con ne faktin qe ne qytetet qe aktualisht ka shkolla jo-publike meqenese jane edhe destinacionet kryesore te drejtimit te migrimeve te popullsise brenda vendit do te perjetojne edhe peshen me te madhe te rritjes se popullsise deri ne vitin 2021. Keshtu qe po ne keto qytete pritet te rritet akoma me shume numri i shkollave private. Megjithate edhe qytete e vogla ne te cilat nuk ka shkolla jo-publike, si pasoje e migrimit te popullsise nga zonat rurale drejt atyre urbane ka shprese qe te fillojne edhe ato te kene sipermarrje te tilla.

Per te vazhduar me sistemin e aresimit te larte mund te thuhet se eshte e vetmja pjese brenda sektorit ne te cilin kerkesa eshte ende e pangopur mire. Kjo per faktin se shkollat e larta jane teresisht shteterore. Mund te permendim vetem NEW YORK University ne Tirane i cili eshte licensuar dhe funksionon qe prej vitit 2002 . Ne vitin 2004 u licensua edhe universiteti “Zoja e Keshillit te Mire”. Keta te tre jane te vetmit universitete private ne vendin tone , qe ne raport me popullsine dhe me kerkesen per aresimin e larte keto mund te kosiderohen shume pak. Pra kuptohet qarte qe ka ende shume hapesire ne tregun e shkollave jo-publike per hyresit e rinj dhe pritjet ne kete drejtim jane shume optimiste.

4 KONKURRENCA E TREGUT

4.1 Aktoret kryesore ne tregun e aresimit (publik dhe jo-publik)

I gjithë tregu aresimor ne vendin tone perbehet nga dy sektore te ndare qarte me njeri tjetere :sektori publik dhe ai jo-publik. Secili prej tyre funksionon ne menyre te pavarur nga njeri –tjetri. Kjo per vete faktin se klientela e synuar prej secilit eshte percaktuar tashme.

Sektori i shkollave publike eshte i hapur ndaj gjithë publikut pa bere dallime rrace, feje, te ardhurash etj. Sherbimi i ofruar ne kete sektor eshte falas, i mbeshtetur nga shteti, dhe i gjithë sektori varet dhe kontrollohet perseri nga shteti.

Ndesa sektori i shkollave jo-publike ka nje klientele me selektive. Fokuson kryesisht tek familjet me te ardhura te konsiderueshme qe jane te gateshme dhe ne gjendje te paguajne per sherbimet e ofruara nga ky sektor. Eshte i pavarur financiarisht nga shteti, dhe detyrimi kryesor ndaj tij eshte pagimi i detyrimeve fiskale dhe respektimi i rregullave dhe normave didaktike te miratuar dhe aprovuar prej tij.

Dallimi kryesor midis te dy sektoreve eshte pikerisht ndarja e qarte e pjeses se tregut gje qe nuk ben te dy sektoret konkurrencte te mirefillte.

Persa i perket sektorit te shkollave jo-publike konkurrencte te drejteperdrejte te tyre jane vete shkollat e tjera jo-publike, te cilat aktualisht

vetem ne Tirane numerohen gati 51 te tilla dhe per nje popullsi gati mbi 500 000 banore kjo shifer tregon per nje rritje dhe intensifikim te konkurrences ne kete rreth.

Pervet dy sektoreve kryesore brenda kesaj industrie, operojne edhe aktore te tjere te cilet kane ndikimin dhe pushtetin e tyre mbi elementet e secilit prej sektoreve te tille si:

- **Ministria e Aresimit dhe Shkences**- kjo ministri eshte pergjgjese per (!)shqyrtimin e dokumentacionit te paraqitur dhe licensimin e shkollave jopublike , (!!) aprovimin e kurrikulave, (!!!) nxjerr dhe zbaton te gjitha aktet ligjore dhe nenligjore qe lidhen me aktivitetin ne sektorin e aresimit publik dhe jo-publik.(!!!!) harton dhe zbaton politikat ne lidhje me aresimin
- **Drejtorite Aresimore** ne cdo rreth te vendit,- te cilat jane pergjgjese dhe monitoruese te ecurise se planeve mesimore dhe administrative te cdo shkolle publike dhe jo-publike.
- **Organet tatimore** (per sektorin e shkollave jo-publike)- kane pergjgjesine e kontrollit te ecurise financiare dhe sigurimin e realizimit te pagesave per detyrimet fiskale, ose perndryshe penalizimet e sanksionuara nga ligji.
- **Keshilli i Ministrave** -kryesisht per te gjitha shkollat jo-publike licensimi ehste pergjgjesis e MASH-se por ne rast se behet fjale per shkolla jo-publike fetare dhe per ato me programe mbi 40% ne gjuhe te huaj , vendimin per dhenien e licences e merr Keshilli i Ministrave. Deri me sote Keshilli i Ministrave ka licensuar vetem 6 shkolla te tilla ne vendin tone si: “Miss of Tirana”(cikli i ulet), “Gjerasim Qirjazi”(8-vjecare vetem per nxenes te huaj), Medresja “Hafiz Mahmut Dashi”(8-vjecare dhe e mesme), ‘Turgut Ozal” (8-vjecare dhe e mesme), “Arsakeio” (8-vjecare), “Mehmet Akif” (e mesme e pergjitheshme). Gjithe institucionet e tjera jo-publike jane miratuar nga Ministria e Shkences dhe Aresimit.

4.2 Shkollat e huaja prezente ne Shqiperi.

Disa nga shkollat jo-publike kane pronesi , drejtues dhe punonjes te huaj ne perberje te tyre. Keta punonjes duhet te kene patjeter leje banimi dhe punesimi ne Shqiperi, te marra keto prane organeve kompetente dhe te bashkangjitura dokumentacionit shkollor. Shkolla te tilla jane: “Ylberi” (spanjolle), “Lucia Filipi” (italiane), “SOS” (austriake), “Fenix” (angleze), 4 shkolla “Turgut Ozal “(turke), “Gjerasim Qirjazi” (amerikane), ‘Arsakeio” (greke), “Saadi” (iraniane), 2 shkolla “Mehemet Akif” (turke), “International School of Tirana” (amerikane), “Protagonistet” (amerikane), ‘Harry Fultz” (amerikane) etj.

Te paret qe kane krijuar shkollë jo-publike ne vendin tone kane qene turqit. Pasi krijuan nje imazh dhe reputacion te mire ne tregun e viteve te para, ata filluan te hapin edhe shkollat te tjera psh. shkollat “Turgut Ozal” jane 4 te tilla, ndersa shkollat “Mehmet Akif” jane dy te tilla. Elementi me joshes per klientelen , te cilin ata e perdoren qe ne momentin e para te hyrjes ne treg ishte fakti se mesimi do te zhvillohej ne gjuhe te huaj, nderkohe qe ne Shqiperi egziston nje interes i larte per njohjen dhe mesimin e gjuheve te huaja, kryesisht te gjuhes angleze. Nga ana tjetere keto tipe shkollash ofronin edhe konvikte per nxenesit e ardhur nga rrethet e vendit.

4.3 Rrjetet e shkollave

Koncepti i rrejteve eshte ende i ri ne vendin tone. Hasen tek –tuk konceptime te tij por qe ende nuk kane marre nje forma te konsoliduar sipas rregullave dhe procedurave qe duhet te kete nje rrjet i mirefillte bashkohor. Tipet me kryesore jane evidentuar kryesisht ne rrejte dyqanesh apo qendrash tregetare, por qe ende jane te cunguara persa io perket infrastruktures dhe shperndarjes se tyre.

Per sa i perkesht subjekteve shkollat jo-publike , ato jane ende ne hapat e para te funksionimit dhe konsolidimit te tyre, dhe nuk behet fjale ende per “rrjete” ne kete sektor. Megjithate disa shkollat, ato qe kane hyre nder te parat ne treg, me kapitale dhe investime te medha, kane filluar te krijojne nje rrjetet perkatese duke perhapur eksperincen e pare te mare nga shkollat baze. Nje shkollë e tille tipike eshte Liceu Inkus i cili ka hapur filialet e tij ne Shkoder dhe Elbasan. Po keshtu Shkollat “Vellezerit Kajtazi-Tirana” ka hapur filialin e saj ne Durres. Njekohesisht te njohura jane rrjetet e shkollave “Turgut Ozal” (perkatesisht me 4 shkollat ne te gjithë vendin) dhe “Mehmet Akif” (me dy te tilla). Pergjithesisht shkollat e te njejtë rrjet kane te njejtat programe, logo, procedura ne seleksionim nxenesish dhe stafi, ndertime, pajisje etj.

4.4 Targetimi i studenteve nga dhe te ardhurat e familjeve frekuentuse.

Klientet ne shkollat jo-publike jane te karaktereve te ndryshme. Nje gje bie ne sy reth 80% e tyre jane nga familje me te ardhura te tilla qe mund te perballojne lehte pagesen mujore te shkolles. Reth 20% e tyre jane nga nje shtrese familjesh qe kane te ardhura mesatare dhe qe e perballojne me nje fare sakrifice pagesen e shkolles per femijet e tyre. Duke qene nje treg i ri fillimisht ne shkollat vetem kerkoheshin kliente dhe nuk i vihej veshi fare nga vinte c’formim kishte nje gje e tille solli dhe pasojat e saj. Klientet vinin ne baze te rekomandimeve te familjeve qe kishin femijet neper shkollat dhe ralle ne menyre te rastesishtme panvaresisht se ne shkollat ne dukje ishte e kunderta. Disa shkollat bejne reklame ne media vizive dhe te shkruara per shkollat e tyre gje e cila ka ndimikimn e saj ne krijimn e klienteles. Tanimë shkollat me emer mbasi kane plotësuar nje seri klasash ose objektivash kane filluar te bejne nje perzghjedhje te klienteve te tyre.

5 TARIFAT E PAGESES KUSHTET E TYRE

Ne aktivitetin e shkollave jo-publike e permendem qe jegzistojne dy tipe ato jo-fitim prurese dhe fitimprures.

Per shkollat qe bazojne aktivitetin e tyre ne te ardhurat qe gjenerojne nga klientet dhe kapitalin investues te pronarit perdoren tarifa pagese per cdo femije. Kjo tarife varet nga nje sere faktoresh qe ne pergjithesi jane:

- Kostoja e shkolles per mesuesit.
- Kostoja e shkolles per sherbimet ndaj nxenesit
 - Librat
 - Ushqimi
 - Transporti
 - Uniforma
 - Eskursione
 - Aktivitete argetuese
 - Sherbumi shendetesor etj
 - Promocionet per nxenesit e suksesshem
- Sherbimet e mirembajtjes
- Shlyerje e investimeve
- Investimi te reja mbi mjete laboratorike didaktike

Keto tarifa varijojne nga shkolla ne shkolle dhe nuk mund te themi qe jane standarte. Kjo per faktin se disa shkolla fusin Brenda tarifes nje sere sherbimesh te detyruara sic mund te jete transporti apo ushqimi, te tjerat jo. Disa shkolla aplikojne ushqimin e plote ne drake disa kane ne forme fast food. Ne disa shkolla eshte i detyrueshem uniforma ne disa jo. Po keshtu mund te themmi edhe per disa libra per kurrikula te vecanta sidomos per gjuhet e huaja.

Sa paguan nje femije ne nje shkolle?

Pergjigja eshte ne “Instituit Arsimor Vellezerit Kajtazi – Tirana” pagesa eshte e pa diferencuar per cdo nxenes te cdo klase qofte ajo eshte 13000 Leke ne Muaj. Cdo nxenes duhet te paguaj edhe 3000 transport ne rast se shkolla e kryen ate. Brenda tarifes eshte future edhe nje ushqim i lehte dreke, asuistenca mjekesore, si dhe periodha e mbasdites per konsultime. Pagesa kerkohet te behet tremujore por nxenesve ju pranohen edhe pagesa mujore. Ne kete shkolle ka edhe nje system bonusesh te tille nxenesi me te gjitha dhjeta paguan 7000 leke ne muaj, nxenesit qe fitojne ndonje trofe neper olimpiada marrin nje bonus prej 500-1000 USD.

Ne “Institutin Arsimor Willson” sistemi i pageses eshte i variueshme per femije te niveleve te ndryshme. Keshtu per kopshtet pagesa mujore eshte 180 EURO ne kete cmim jane te inkluduar transporti, ushqimi mengjes dhe drake, uniforma, librat, canta me logon e shkolles, asistenca mjekesore dhe konsultimet e mbasdites qe jane reth 1 ore mbas kohes se ushqimit te drekes. Per klasat e para deri ne klasen e katert aplikohet nje tarife 240 Euro per klasat e 5 deri me te tete 270 Euro dhe per shkollen e mesme 280 Euro.

Ne “Liceun Inkus” tarifa ehte fikse 22000 Leke ne muaj ketu perfshihet transporti. Pagesa e saj duhet te behet tremujore por nuk ka kushte rigoroze ajo mund te behet edhe mujore dhe lejohen edhe cregullime te tjera.


Ne shkollen Drita e Diturise cmimi eshte 15000 Leke me vehte eshte pagesa e transportit e cila eshte ditore dhe eshte 100Leke dhe ushqimi gjithashtu eshte ditor dhe eshte 150Leke ne dite.

Shkolla Memorial International eshte nje shkolle disi specifike mbasi aty ka shume pedagoge te huaj dhe metodika e mesimit eshte krejtesisht e ndryshme nga te tjeret. Tarfa e tyre shte vjetore dhe eshte 4000 EURO ne vit dhe per transportin eshte 300 EURO ne vit. Ne kete pagese perfshihen shume fasilite dhe sherbime qe ju behen femijeve.

Shkolla Ekonomisti ka tarife 15000Leke ne mauj dhe shtese per transportin mujor 3000 Leke. Ne kete shgkolle perdoren edhe tarifa te diferencuara per klientet qe kane probleme ekonomike qe lindin nga gjendja jo e mire familjare si ata me prinder te divorcuar ose me prinder te munguar etj.

Cmimet e mesiperme jane cmimet aktuale te shkollave per vitin 2004. Kjo politik cmimesh ka ardhur duke u shtrenguar konkretisht ne shkollen inkus kemi kete ecure cmimesh ne vite.

Viti	Tarifa/Mujore
1998	100 USD
1999	100 USD
2000	100 USD
2001	150 USD
2002	150 USD
2003	150 USD
2004	22000Leke



6 PARAMETRAT DHE STANDARTET

6.1 Legjislacioni perkates

Egzistenca e nje institucioni jo publik edukativ bazohet ne disa parapetra dhe standarte te detyrueshme per zbatim. Ministria e Arsimit dhe e Shkences se bashku me institucionet e saj ne varesi jane aktualisht sturkturat pergjigjese per hartimin, krijimin, aprovimin, monitorimin si dhe anulimin e ketyre parametrave dhe standarteve. Keto rregulla jane sanksionuar ne legjislacionin shqiptar neperjet ligjeve vendimeve te keshillit te ministrave, udhezimeve te ndryshme te ministries etj.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës është institucion qendror i cili veprimtarinë e tij e ushtron në përputhje me një sërë ligjesh, ku më kryesori është ligji Nr.8872, datë 29.03.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj eshte gjithashtu edhe baza e ligjshmerise edhe per arsimin jo publik. Qëllimi i këtij ligji është të mbështesë zhvillimin e një sistemi të përbashkët të arsimit dhe formimit profesional në Republikën e Shqipërisë, i cili mund tu përshtatet ndryshimeve shoqërore, ekonomike e teknologjike dhe nevojave të tregut të punës, si edhe të mundësojë një burim optimal të burimeve financiare, njerëzore dhe infrastrukturore. Sipas këtij ligji, arsimi dhe formimi profesional është publik dhe jopublik dhe garantohet nga shteti. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka të drejtën e dhënies së lejeve për:

- Funksionimin e institucioneve arsimore jopublike (IAJP) dhe institucioneve arsimore plotësuese jopublike (IAPJP), laike dhe në gjuhën shqipe.
- Funksionimin e IAJP dhe IAPJP, fetare ose me mësimë në gjuhë të huaj.
- Leje për funksionimin e shkollave të larta jopublike.

Dhënia e Lejeve bëhet në përputhje me:

- Ligjin Nr.7952, datë 21.06.1995 “Për sistemin arsimor Parauniversitar”
- Ligjin Nr.8387, datë 30.07.1998 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.7952, datë 21.06.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”
- Ligjin Nr. 8461, datë 25.02.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligjin Nr. 9120, datë 28.07.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8461, datë 25.02.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”
- VKM Nr. 248, datë 28.05.1999 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes për funksionimin e institucioneve arsimore jopublike dhe të institucioneve arsimore plotësuese jopublike ku zhvillohen lëndë fetare ose ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj.
- VKM Nr. 156, datë 22.03.2001 “Për shkollat e larta jopublike në Republikën e Shqipërisë”.

- Udhëzimin Nr. 6, datë 17.02.2004 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes së funksionimit për institucionet arsimore jopublike dhe institucionet arsimore plotësuese jopublike parauniversitare”.

6.2 Lejet dhe rregulloret.

6.2.1 Leja për funksionimin e institucioneve arsimore jopublike (IAJP) dhe institucioneve arsimore plotësuese jopublike (IAPJP), laike dhe në gjuhën shqipe.

Kjo leje ka për qëllim ushtrimin e aktivitetit në fushën e arsimit parauniversitar. Organi kompetent për dhënien e kësaj leje është MASH. Për pajisjen me këtë leje aplikojnë shumë subjekte private të interesuara, por marrin leje vetëm ato subjekte të cilat plotësojnë kushtet dhe kriteret e vendosura sipas akteve ligjore e nënligjore.

Në struktura të tjera plotësuese që ndihmojnë, mbështetin dhe pasurojnë sistemin arsimor mund të futen qendrat kulturore, qendrat e vlerësimit, qendrat e dokumentacionit shkollor, lektoriumet, kurset speciale, qendrat e formimit profesional, institutet e rritjes së shkallës së kualifikimit, etj. Strukturat plotësuese të arsimit janë nën varësinë e dikastereve dhe të organizmave që i kanë krijuar.

6.2.2 Kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për dhënien e kësaj lejeje

Subjekti që dëshiron të hapë një institucion jopublik, për marrjen e lejes së funksionimit, duhet të paraqesë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës kërkesën të shoqëruar me këto **dokumenta**:

- a) Lloji i institucionit arsimor për të cilin kërkohet leje.
- b) Deklarata sipas së cilës subjekti merr përsipër të respektojë të gjitha dispozitat e ligjit “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar” dhe të gjitha aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.
- c) Dokumenti i regjistrimit në gjykatë si person juridik me të drejtë të ushtrimit të aktivitetit në fushën e arsimit privat. Aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.
- d) Dokumentacioni ligjor, që i jep të drejtën subjektit të përdorë ndërtesën dhe mjediset e tjera ndihmëse në vendin ku do të funksionojë institucioni, me afat kohor minimal sa zgjatja e një cikli shkollor, me sipërfaqe dhe mjedise të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor në të gjitha nivelet, për të cilat subjekti do të liçensohet. Kontrata duhet të jetë e shoqëruar me dokumentin e pronësisë lëshuar jo më parë se 3 muaj nga data e paraqitjes së dokumentacionit.
- e) Leja higjeno-sanitare nga Inspektoriati Sanitar Shtetëror.
- f) Shërbimet që ofron dhe tarifat për frekuentimin në institucion.
- g) Emërtimi i institucionit, adresa e tij e saktë, nivelet e arsimit, numri i grupeve apo klasave me të cilat do të punohet, numri i nxënësve për klasë. Të specifikohet nëse do të përdoren dëftesat e shkollave ekuivalente publike apo do të përdoren të tjera. Në çdo rast, të sillet një kopje e dëftesës tip që do të lëshohet për të gjitha nivelet.
- h) Plani mësimor që do të zbatojë institucioni.
- i) Programet lëndore që do të zbatojë institucioni.

- j) Lista e teksteve që do të përdoren në lëndët mësimore të detyruara dhe në lëndët mësimore shtesë, me zgjedhje apo fakultative.
- k) Lista e plotë e stafit drejtues, mësimdhënës dhe ndihmës, përfshirë edhe administratorin. Për secilin prej tyre të paraqitet fotokopje e noterizuar e dokumentit të arsimit të kryer dhe CV. Të deklarohet se cili do të jetë drejtuesi didaktik i institucionit i cili duhet të jetë me arsimin përkatës. Subjekti duhet të provojë se ka personel mësimdhënës të mjaftueshëm dhe me arsimin përkatës për zhvillimin e të gjitha orëve të mësimit të parashikuara në planin mësimor. Për të diplomuarit jashtë shtetit duhet dokumenti i njohjes së diplomës. Detyrimisht 60% e stafit mësimdhënës të jetë efektiv me ngarkesë të plotë.
- l) Për shtetasit e huaj duhet të paraqitet leja e qëndrimit në Shqipëri nga Ministria e Rendit dhe leja e punës nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.
- m) Inventari faktik i bazës materiale dhe asaj didaktike që disponohet dhe që është në funksion të arsimit, edukimit dhe realizimit të kërkesave të programeve lëndore, duke provuar se mjetet mësimore janë të mjaftueshme për të realizuar kërkesat e planit mësimor dhe të programeve lëndore.
- n) Dokumenti që vërteton garancitë financiare të subjektit që do të fillojë aktivitetin privat (minimumi 100.000 lekë).
- o) Dëshmitë e penalitetit për administratorin dhe drejtuesin didaktik të institucionit.
- p) Informacion mbi planin afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit institucional, format e organizimit të mësimit dhe të kontrollit të dijeve tek nxënësit, të drejtat dhe detyrimet e nxënësve dhe mësuesve.

Më pas MASH kryhen verifikimin e gjendjes fizike të objektit para dhënies së lejes për funksionim. Në rastet kur konstatohen mangësi të standarteve të lejuara, vendosen afate për përmirësimin e tyre duke e pezulluar dhënien e lejes deri në plotësimin e tyre. Në rastet kur objektet e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat dhe standartet e vendosura për realizimin e plotë të procesit mësimor, atëherë MASH ndërpret procedurën e filluar për liçensim.

Nëse vërehen mangësi në dokumentacionin e paraqitur më sipër, subjekti njoftohet për t'i eliminuar ato brenda një afati të caktuar. Mosplotësimi i mangësive brenda afateve të përcaktuara sjell si pasojë ndërprerjen e procedurës së filluar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për liçensim.

6.2.3 Proçedurat e miratimit të lejes

Dokumentacioni i paraqitur për miratim, detyrimisht i protokolluar, pasi kalon tek ndonjëri nga titullarët, merret në dorëzim nga një grup prej dy personash që ngarkohen nga Zv. Ministri – kryetar i grupit. Dosja e përgatitur nga subjekti vlerësohet nga secili prej anëtarëve të grupit të cilët përgatiten me shkrim për të raportuar në mbledhjen e grupit. Në të njëjtën kohë bëhet edhe verifikimi i plotësimit të kriterëve për t'u konsideruar institucion arsimor. Bazë për këtë vlerësim shërbejnë normativat e ndërtimit dhe funksionimit, pajimet tip të çdo lënde mësimore dhe konsiderata të tjera të domosdoshme për një institucion arsimor. Në rast se kërkesa e subjektit është në përputhje me të gjitha kriteret e vendosura, sekretari i grupit përgatit urdhërin e miratimit, në të cilin firmosin të gjithë anëtarët dhe kryetari. Dosja dhe urdhëri i miratimit i paraqiten Ministrit, i cili bën vlerësimin e tij. Në rast të përgjigjes negative, subjekti mund ta ripërsërisë kërkesën, pasi të plotësojë kushtet dhe dokumentacionin, vitin e ardhshëm shkollor.

6.2.4 Afati kohor

Afati kohor për dhënien e liçensës për arsimin parauniversitar (kopshte, shkolla) është jo më shpejt se 3 muaj, por jo më vonë se 1 vit nga data e aplikimit në MASH, ndërsa për arsimin parauniversitar plotësues (kurse të ndryshme) jo më shpejt se 2 muaj, por jo më vonë se 1 vit nga data e aplikimit në MASH. Kjo liçencë nuk ka afat rinovimi.

6.2.5 Kostoja për dhënien e liçensës

Institucionet Arsimore Jopublike Parauniversitare (IAJP) dhe Institucionet Arsimore Plotësuese Jopublike Parauniversitare liçensohen përkundrejt tarifave të mëposhtme:

Institucionet	Tarifat në lekë
Kopshtet	30.000
Shkollat e ciklit të ulët fillor	40.000
Shkollat e ciklit të lartë 8 vjeçar	40.000
Shkollat 8 vjeçare (cu + cl)	60.000
Shkollat e mesme të përgjithshme	50.000
Shkollat e mesme tekniko-profesionale e social-kulturore	60.000
Kurset plotësuese	60.000

6.2.6 Leje për funksionimin e IAJP dhe IAPJP, fetare ose me mësim në gjuhë të huaj

Organi kompetent për dhënien e lejeve për institucionet arsimore private, ku mësimet zhvillohen edhe në gjuhë të huaj ose kur zhvillohen edhe lëndë fetare, është Këshilli i Ministrave, me propozimin e MASH. Leja jepet kur planet, programet mësimore dhe kushtet e realizimit të tyre nuk bien në kundërshtim me interesat kombëtare, me legjislacionin shqiptar, me rendin publik, normat morale dhe higjenën, si dhe kur sigurohen kushtet materiale të domosdoshme së bashku me personelin e nevojshëm mësimor. Në institucionet e sipërpërmendura gjuha dhe letërsia shqipe, historia e kombit shqiptar dhe gjeografia e Shqipërisë zhvillohen detyrimisht në shqip.

Për shkollat e tjera private, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare ose në të cilat mësimi bëhet edhe në gjuhë të huaj kriteret dhe procedurat caktohen me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Arsimit.

6.2.7 Dokumentat që duhen për dhënien e lejes

Së pari paraqitet një kërkesë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës e shoqëruar me dokumentat e mëposhtme:

- Deklaratën, në të cilën subjekti merr përsipër respektimin e dispozitave ligjore e nënligjore, që rregullojnë funksionimin e institucioneve arsimore jopublike dhe të institucioneve arsimore plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare ose ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe të Konventës së të Drejtave të Fëmijëve.

- b) Vendimin e gjykatës së rrethit të Tiranës për regjistrimin si person juridik në Regjistrin Tregtar, ku të jetë përcaktuar objekti i veprimtarisë në fushën e arsimit, formimit dhe edukimit.
- c) Dokumentacionin e nevojshëm, që vërteton se kërkuesi ka një ndërtesë, truall dhe mjedise të tjera ndihmëse për funksionimin normal të institucioneve arsimore jopublike. Për ndërtesat, trojet dhe mjediset e tjera, që janë pronë shtetërore, nuk do të pranohet kontrata e uzufuktit.
- d) Vërtetim nga Inspektoriati Sanitar dhe organet e pushtetit vendor, se ndërtesa dhe mjediset e tjera ndihmëse plotësojnë kushtet higjeno-sanitare, të mbrojtjes kundër zjarrit dhe kërkesat e tjera të të qenit institucion arsimor, sipas normave ligjore. Ky vërtetim duhet të marrë parasysh rregullat për sigurimin e jetës e të shëndetit, të mësuesve shqiptarë e të huaj, si dhe dispozitat e ligjit për shërbimin shëndetësor, stomatologjik në shkollë, si dhe rregulloren e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për shërbimin shëndetësor në institucionet parashkollore dhe shkollore.
- e) Garancinë për burimet e financimit, së bashku me tarifën e frekuentimit për nxënësit.
- f) Dokumentin e numrit të identifikimit si person i tatueshëm, të lëshuar nga zyra e tatim-taksave e degës pranë së cilës ai ushtron veprimtarinë, për shlyerjen e detyrimeve fiskale.
- g) Emërtimin e institucionit arsimor jopublik, adresën, llojin e institucionit dhe titullin e dokumentit, që lëshohet në përfundim të tij apo të çdo viti shkollor.
- h) Planin dhe programet mësimore, që do të zhvillojë institucioni. Struktura e vitit shkollor e institucioneve arsimore jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare ose ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, të jetë e barasvlefshme me atë të shkollave publike të të njëjtit nivel, së bashku me kalendarin e veprimtarive vjetore. Për institucionet arsimore plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare ose ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, duhet të përcaktohet kohëzgjatja, struktura, nivelet apo modulet e formimit që zhvillojnë.
- i) Listën e plotë të stafit drejtues, mësimdhënës e ndihmës. Përcaktimi i drejtorit administrativ dhe i drejtuesit për problemet mësimore - edukative. Për stafin administrativ dhe mësimor-edukativ duhet të paraqiten diplomat përkatëse, vërtetimet për kualifikimet e kryera, dëshmia e penalitetit, së bashku me disa gjeneralitete. Kur pjesëtarë të këtij stafi nuk janë shtetas shqiptarë, përveç kërkesave të mësipërme do të paraqesin edhe dokumentacionin e përcaktuar, sipas dispozitave ligjore për të huajt. Ky dokumentacion do të rinovohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës çdo fillim viti shkollor, sipas ndryshimeve të mundshme, në rast se ka të tilla.
- j) Listën e teksteve bazë, që do të përdoren nga ky institucion:
 - lëndët mësimore të detyrura njëloj me ato të shkollave publike;
 - lëndët mësimore të ndryshme nga ato të planeve mësimore të institucioneve ekuivalente, publike;
 - lëndët me zgjedhje dhe ato fakultative.
- k) Këto tekste duhet t'u vihen në dispozicion organeve arsimore, kur një gjë e tillë kërkohet nga ata.
- l) Listën e bazës materiale, didaktike, që ka institucioni arsimor jopublik në shërbim të realizimit të kërkesave të planit e të programit arsimor.
- m) Miratimin nga Sekretariati Shtetëror i Fesë, i planit mësimor, i programeve lëndore dhe i teksteve të pjesës jolake, për subjektet fetare, vendase apo të huaja, dhe për subjektet që përfaqësojnë subjektet fetare në Shqipëri, që

drejtojnë e organizojnë institucionet arsimore jopublike dhe institucionet arsimore plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare.

- n) Rregulloren e brendshme të institucionit, e cila duhet të ketë si qëllim përcaktimin e raporteve ndërmjet drejtuesve, personelit mësimdhënës dhe ndihmës, nxënësve, prindërve, etj.
- o) Rregullat dhe kriteret e vendosura nga institucionet për pranimin e personelit dhe të nxënësve.

6.2.8 Afati kohor për dhënien e lejes

Leja për hapjen e institucioneve arsimore private nuk mund të jepet më parë se 1 vit nga koha e dorëzimit të kërkesës.

Kjo leje hiqet po nga Këshilli i Ministrave. Shkollat private, të cilave u është hequr leja, mund të bëjnë kërkesë për ta rifituar atë për vitin e ardhshëm shkollor.

6.2.9 Leje për funksionimin e shkollave të larta jopublike

Leja shtetërore për funksionimin e shkollave të larta jopublike dhe mbyllja e tyre, bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave në bazë të propozimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Kjo e fundit është përgjegjëse për standartet e veprimtarisë mësimore, kërkimore e kualifikuese të shkollës së lartë jopublike. Proçesi i dhënies së lejes për shkollat e larta jopublike përfshin dy faza:

- a) Dhënien e lejes, e cila jep të drejtën e hapjes dhe të fillimit të proçesit mësimor;
- b) Akreditimin, i cili bën të mundur njohjen e kursit të studimit dhe të shkollës.

6.2.10 Kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për marrjen e kësaj lejeje

Subjekti që dëshiron të hapë një shkollë të lartë jopublike, për marrjen e lejes, duhet të paraqesë një kërkesë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, e cila duhet të shoqërohet me këto **dokumente**:

- a) Vendimin e Gjykatës së Rrethit për regjistrimin si person juridik.
- b) Aktin e themelimit.
- c) Emrin, vendndodhjen, një kopje të dokumenteve të regjistrimit dhe të liçensës së mësimit të vendit nga vjen (në qoftë se enti financues është person juridik, i huaj) dhe tipin e shkollës së lartë jopublike që kërkon të hapë.
- d) Statusin, i cili duhet të përmbajë: emrin e plotë të shkollës së lartë jopublike, adresën, tipin, qëllimin dhe zgjatjen e proçesit mësimor, gjuhën e zhvillimit të mësimit, organet drejtuese dhe kompetencat e tyre, financimin dhe veprimtarinë ekonomike, proçedurat për pranimin dhe diplomimin e studentëve, të drejtat dhe detyrat e studentëve, kriteret për punësim, normën mësimore-shkencore, kohën e punës dhe të pushimit, marrëdhëniet me shkollat e larta, të drejtat dhe detyrat e personelit.
- e) Rregulloren e brendshme, e cila duhet të përmbajë: dispozitat e përgjithshme, strukturën organizative, format e organizimit të studimeve dhe të kontrollit të dijeve, diplomimin, të drejtat dhe detyrimet e studentit e të pedagogëve, standartet etike.

- f) Të dhënat rreth kursit të studimit, të cilat duhet të jenë në përputhje me standardet e hartuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
- g) Listat e plota të personelit drejtues, të personelit akademik (të brendshëm dhe të jashtëm), të personelit ndihmës mësimor-shkencor, të personelit administrativ, së bashku me disa gjeneralitete: datëlindja dhe vendlindja, kombësia dhe shtetësia, arsimimi, specialiteti, diploma dhe kualifikime të tjera të dokumentuara, detyra funksionale në institucion, dëshmia e penalitetit.
- h) Një katalog me listën e vendeve të punës dhe me kërkesat për çdo vend pune.
- i) Planin afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit institucional.
- j) Dokumentet që vërtetojnë garancinë financiare për financimin e personelit dhe të gjitha veprimtarive mësimore-shkencore të shkollës së lartë jopublike për një cikël të plotë për çdo kurs studimi. Dokumenti i garancisë financiare duhet të paraqitet çdo vit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
- k) Deklaratën në të cilën subjekti angazhohet të sigurojë një dokument pronësie apo kontratë qeraje për ndërtesën në të cilën do të funksionojë shkolla e lartë jopublike. Dokumenti i pronësisë ose kontrata e qerasë duhet të realizohet jo më vonë se 3 muaj para fillimit të vitit akademik shkollor. Në rastin e kontratës së qerasë, afati i saj duhet të jetë sa zgjatja e kursit mësimor.
- l) Vërtetimin nga Inspektoriati Sanitar për konfirmimin që mjedisi i plotëson kushtet higjeno-sanitare, pasi është siguruar dokumenti i pronësisë ose kontrata e qerasë.
- m) Dokumentin e identifikimit të subjektit juridik, si person i tatueshëm, si dhe vërtetimin nga dega e tatim-taksave.
- n) Autorizimin nga zyra e punës të rrethit përkatës ku ushtrohet veprimtaria, si dhe nga Inspektoriati i Punës.

6.2.11 Afati kohor

Leja e sipërpërmendur jepet jo më shpejt se 6 muaj, por jo më vonë se një vit nga data e aplikimit për marrjen e saj. Këto dy lloj licencash nuk kanë as afat rinovimi dhe as kosto.

7 KONKLUSIONE

POPULL ARSIMDASHES

Aresimi eshte nje nder vlerat kryesore e me te spikatura te popullsisë ne vendin tone. Jane bere shume perpjekje dhe sakrifica nga individë te shquar te cilet kane dhene edhe kontributin e tyre ne kete drejtim. Edhe gjate sistemit totalitarist atij i eshte kushtuar nje rendesi e vecante gje qe mbeshtetet edhe nga fakti qe shumica e infrastruktures aktuale institucionale dhe pedagogjike eshte po ajo qe na ka mbetur e trasheguar nga regjimi i kaluar, por tashme me nje mendesi te re.

PROFILIZIMI I KERKESES PER DY LLOJ ARSIMESH PUBLIK DHE JO-PUBLIK

Krahas investimeve te bera ne te kaluaren ne fushen e aresimit, pas viteve '90, duke u bere shume evidente mangesite, mungesat dhe ineficenca e sitemit aresimor, u vu re ne treg nje kerkes e re e cila fokusonte drejt nje aresimimi sa me cilesor dhe qe u kap shume shpejt nga investitore te ndryshem qe iniciuan per here te para edhe shkollat e para jo-publike. Ne keto momente te veshtira, filluan ndarjet e para te sistemit aresimor ne dy drejtime dhe gradualisht sektori i ri i shkollave jo-publike filloi te marre forme dhe te konsolidohet gjithenje e me shume vit pas viti.

FILLIMI I INSTITUCIONEVE EDUKATIVE JO-PUBLIKE

Fillimi i ketyre iniciativave u shfaq ne **vitet 1993-1994** reth dy vjet mbasi u krijua edhe nje shtrese e njerezve qe krijuan disa burime financiare qe mund te perballonin edhe nje pagese mbi shpenzimet tradicionale familjare per mbarevajtjejn dhe aresimimin e femijeve te tyre ne nje menyre me komode e te regullt se sa tregu i institucioneve publike.

SHPERNDARJA GJEOGRAFIKE KU TIRANA ESHTË TREGU KRYESOR

Tirana eshte rrethi ne te cilin u vune re tendencat e para, dhe aktualisht po kjo kryeson persa i perket perqendrimin me te madh te shkollave jo-publike. Me pas mendesia dhe pretendimi per nje aresim sa me cilesor te femijeve dhe te rinjve filloi te perhapej me shpejtesi edhe ne rrethet kryesore te vendit. Pas Tiranes vijne dhe renditen pikerisht qytete ne te cilat eshte evidentuar popullsia dhe dendesia me e madhe si Vlora, Durresi, Fieri, Elbasani, Korca, Shkodra. Njekohesisht edhe zhvillimi me i madh ekonomik eshte perqendruar ne keto qytete, qe do te thote mundesi me te medha financiare per te mbeshtetur nje sherbim privat si ai i ofruar nga shkollat jo-publike.

STATISTIKAT E SOTME TE SHKOLLAVE JO PUBLIKE

Sot numerohen rreth **229** institucione jo-publike edukative me 25813 nxenes. Edukimi parashkollor ka 85 institucione qe kane 4151 femije me 223 edukatore. Arsimi i detyrueshem tete vjecar ka gjithesejt **90** shkolla me 13553 nxenes dhe 1023 mesues. Arsimi i mesem **51** shkolla nga te cilet 8 profesionale. Me 7704 nxenes nga te cilet 2077 ne shkolla profesionale dhe me 722 mesues nga te cilet 174 per shkollat profesionale. Arsimi i larte ka vetem **tre universitete** aktualisht jane reth 405 studente dhe 54 pedagogje (keto shifra i perkasin vetem dy universiteteve mbasi i treti eshte hapur vetem tani dhe akoma nuk ka te dhena te sakta). Universitetet jane vetem ne Tirane.

RITMET E RITJES (TENDENCA) SE SEKTORIT TE INSTITUCIONEVE EDUKUESE JO PUBLIKE

Brenda harkut kohor 2000-2004 vihet re nje rritje me ritme te larta te numrit te nxenesve si dhe te hapjes se shkollave jo-publike. Keshtu Nr i nxenesve nga 9235 ne vitin 2000 ne 23290 ne vitin 2004 pra 252%. Ky fenomen nuk eshte shfaqur vetem ne Tirane por edhe ne rrethet me kryesore te vendit. Perkatesisht vetem 4 vitet e fundit shenohet nje rritje e numrit te shkollave te reja jo-publike te sistemit 8-vjecar me 22 shkolla, nje rritje e numrit te shkollave te mesme (te pergjitheshme dhe profesionale) me 29 shkolla, dhe e sistemit te larte universitar me 3 Universitete. Pergjithesisht rritjet jane shenuar keryesisht ne Tirane, por keto po pesojne cdo dite e me shume shtrirje gjeografike. Vlen te theksohet fakti qe edhe shkollat e tjera qe kane egzistuar kane zgjreruar kapacitete e tyre duke perballuar keshtu numri ne ritje te nxenesve te tyre.

ARSIMI JO_PUBLIK PROFESIONAL (TENDENCA)

Pervez zinxhirit **aresim parashkollor(kopshtet)-aresim 8-vjecar-aresim i mesem i pergjithshem -aresim i larte**, sektori i shkollave jo-publike pritet te zgjerohet edhe ne drejtimin **aresim i mesem profesional**, i cili sherben ende nje pjese shume te vogel te kerkeses korrente ne treg. Aktualisht tregu i punes ne vendin tone eshte i paqarte dhe i paekuilibruar. Pritet qe pasi ky te stabilizohet ateherë dhe vetem ateherë do te kete kerkesë me te qarte per aresimin e larte dhe per pasoje edhe matje me te sakte te pjeses se kerkeses qe do te vije nga ky treg per fuqi puntore te kualifikuar sipas specifikave perkatese. Ajo pjese e kerkeses qe do te mbetet, neqoftese supozojme se eshte plotesuar kerkesa per burime njerezore qe detyrimisht duhet te kene diplome universitare, do te plotesohet automatikisht me kualifikime qe vijne nga shkollat e mesme profesionale. Pritet qe edhe perqendrimi i ketyre tipe shkollave jo-publike te profilizuar te jete me i madh ne Tirane dhe me pas te pesoje rritje edhe ne rrethe.

Dyke gjykuar ne baze te numrit aktual te popullsisë, projektimit te saj per vitin 2021 qe mendohet te kape shifren 3 702 000 banore, rritjes se dendesise se banoreve ne zonat urbane, rritjes se mireqenies ekonomike (vetem per vitin e fundit behet fjale per nje rritje ekonomike rreth 6% te kombinuara keto edhe me efektet e priteshme te reformave dhe strategjive rritesë e zhvilluesë te qeverise, pamja e sektorit te shkollave jo-publike ne vend premtan te jete shume me optimiste.

Fund

Tirane Tetor 2004